



MUNGESË ANGAZHIMI?



**NJË VËSHTRIM
MBI SPEKTRIN
E POLITIKAVE TË
VENDEVE ANËTARE TË
BE-së NDAJ KOSOVËS**

**JAMES KER-LINDSAY DHE
IOANNIS ARMAKOLAS**

MUNGESË ANGAZHIMI?



**NJË VËSHTRIM
MBI SPEKTRIN
E POLITIKAVE TË
VENDEVE ANËTARE TË
BE-së NDAJ KOSOVËS**

**JAMES KER-LINDSAY DHE
IOANNIS ARMAKOLAS**

Editoret:

James Ker-Lindsay dhe Ioannis Armakolas

Layout and Design

Faton Selani

November 2017

Prishtina

Publikuar nga: Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur - KFOS

Imzot Nikë Prelaj, Nr. 13, 10 000 Prishtina Kosovë

Për më shumë informata: info@kfos.org www.kfos.org

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur - KFOS

00 **AUTORËS** **07**

00 **HYRJA** **10**

01 **MBRETËRIA
E BASHKUAR** **13**

02 **GJERMANIA** **17**

03 **REPUBLIKA
ÇEKE** **23**

04 **POLONIA** **27**

05 **GREQIA** **31**

06 **SLLOVAKIA** **37**

07 **RUMANIA** **43**

08 **QIPROJA** **49**

09 **SPANJA** **53**

10 **DIPLOMACIA
KOSOVARE PAS
PAVARËSISË** **57**

AUTO

JAMES KER-LINDSAY

James Ker-Lindsay është profesor i politikës dhe politikave në Universitetin St. Mary's në Twickenham, dhe vizitor i lartë studimesh në London School of Economics dhe Shkencat Politike, ku më parë ka qenë hulumtues i lartë mbi politikat e Evropës Juglindore. Kërkimet e tij fokusohen në konflikt, paqe dhe siguri në Evropën Juglindore, dhe në ndarjet dhe njohjet në politikën ndërkombëtare. Ai është autor dhe redaktor i mëse dhjetë librave, përfshirë edhe Politika e Jashtme Kundër Ndarjes: Parandalimi i Njohjes së Shteteve të Kontestuara (Oxford University Press).

JULIA HIMMRICH

Julia Himmrich është studiuese post-doktorante Dahrendorf në LSE, IDEAS. Më herët ka qenë studiuese hulumtimesh mbi Mbrojtjen Evropiane pranë Rrjetit Evropian të Liderit (ELN) dhe ka ligjruar Politikë të jashtme evropiane dhe gjermane në King's College, Londër. Ajo mban titullin PhD (Doktor Filozofie) nga LSE mbi njohjen e Kosovës nga Gjermania në vitin 2008. Interesat e gjëra të kërkimeve të saj shtrihen në politikat e jashtme dhe politikat e mbrojtjes si dhe zgjidhjet e konflikteve.

DORËT

TOMÁŠ DOPITA

Tomáš Dopita mban titullin PhD (Doktor Filozofie) në Marrëdhënje Ndërkombëtare nga Fakulteti i Shkencave Sociale, në Universitetin e Çarlsit në Prangë. Aktualisht punon si hulumtues i lartë në Institutin e Marrëdhënjeve Ndërkombëtare në Pragë dhe së shpejti do jetë kryeredaktor i Mezinárodní vztahy – Revistës Çeke për Marrëdhënje Ndërkombëtare. Hulumtimet e tij fokusohen kryesisht në përplasjet e subjekteve kolektive në Bosnje dhe Hercegovinë, integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor, gratë dhe gjinia në zhvillimet ndërkombëtare, dhe mundësitë e barabarta në shërbimet e huaja.

JAROSŁAW WIŚNIEWSKI

Jarosław Wiśniewski ka qenë kërkues vizitor pranë Hulumtimeve mbi Evropën Juglindore në LSSE, Insituti Evropian i London School of Economics. Ai mban titullin PhD (Doktor Filozofie) në Studime Evropiane nga King's College, Londër dhe ka punuar më herët si këshilltar për Komitetin Evropian, Këshillin e Evropës, Këshillin Britanik, si dhe në disa organizata të ndryshme evropiane të shoqërisë civile dhe institucione të ndryshme publike dhe private në BE dhe Evropë Juglindore: Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, dhe Serbi ndër të tjera. Aktualisht ai po punon në librin "Sigurimi i Politikës Evropiane të Energjisë" (Routledge, 2018).

IOANNIS ARMAKOLAS

Ioannis Armakolas është asistent profesor në Departamentin e Studimeve ballkanike, sllave dhe orientale, në Universitetin e Maqedonisë (Selanik), anëtar hulumtues 'Stavros Costopoulos' dhe Drejtues i Programit për Evropë Juglindore në Fondacionin Helenik për Politika Evropiane dhe të Jashtme (ELIAMEP) në Athinë. Ai është edhe kryeredaktor i revistës shkencore Studime të Evropës Juglindore dhe Detit të Zi, që botohet nga Routledge, Taylor dhe Francis Group.

MILAN NIČ

Milan Nič është Studies i lartë pranë Këshillit Gjerman për Marrëdhënje me Jashtë (DGAP) në Berlin. Deri në vitin 2016, ai ka qenë drejtor i degës së organizatës think-tank Globsec, me bazë në Bratisllavë. Ai ka ndjekur studimet në Universitetin Johns Hopkins SAIS Qendër Bolonjë, Universitetin e Evropës Qendrore, dhe në Universitetin Çarls në Pragë. Ai ka punuar si këshilltar i Përfaqësuesit të Lartë të BE-së në Sarajevë, si analist për Iniciativën Evropiane për Stabilitet në Vjenë, dhe si këshilltar i zëvendës ministrit të jashtëm sllovak (2010-12).

PAUL IVAN

Paul Ivan është Analist i lartë i politikave në Qendrën Evropiane të Politikave (EPC), ku punon në programet e Evropës në Botë dhe Institucionet dhe Politikat Evropiane. Para se t'i bashkohej EPC-së, Paul ka shërbyer si diplomat në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Rumanisë, si hulumtues pranë Qendrës Evropiane për Studime Politike (CEPS) në Bruksel dhe si hulumtues në marrëdhëniet e jashtme dhe çështjet e sigurisë së BE-së në Qendrën Rumune për Politika Evropiane. Paul mban titullin MSc në Marrëdhënie Ndërkombëtare nga London School of Economics and titullin bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare, Studime Evropiane dhe Histori.

ISABELLE IOANNIDES

Isabelle Ioannides është Hulumtuuese e lartë e asociuar në degën 'Politika të Jashtme dhe të Sigurisë në Evropë' pranë Institutit të Studimeve Evropiane, në Universitetin Vrije, Bruksel. Ajo ka kryer studimet e saj të post-doktoraturës në Universitetin Vrije në Amsterdam mbi Reformën e fushës së sigurisë (RFS) në Kosovë, të mbështetur nga BE-ja, dhe ka përfunduar një hulumtim të mbështetur nga Komisioni Evropian mbi këtë temë, gjatë një qëndrimi në Prishtinë në vitin 2010. Ajo ka botuar punime mbi rolin e BE-së në botë, veçanërisht në proceset paqeruajtëse dhe shtetndërtuese në shoqëritë në tranzicion, përfshirë edhe sundimin e ligjit dhe RFS, si dhe në menaxhimin e krizave nga BE-ja në Ballkanin Perëndimor.

RUTH FERRERO-TURRIÓN

Ruth Ferrero-Turrión është Profesoreshë e jashtme e Politikave Krahasuese dhe Studimeve Evropiane në Universitetet Komplotense dhe Karlos III dhe Bashkëdrejtuese e Grupit për Studime Evropiane dhe Euroaziatike (GEur-asia). Ajo është edhe hulumtuese e lartë në Institutin Komplotense të Studimeve Ndërkombëtare (ICEI) ku drejton Programin e arsimit të vazhdueshëm mbi Migrimin dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Politikat e Azilit në BE dhe Kontekstet e Reja në Ballkan. Që nga viti 1996, ajo ka qenë vëzhguese ndërkombëtare e proceseve të ndryshme zgjedhore në disa vende të Evropës Lindore (Maqedoni, Bosnje dhe Herzegovinë, Shqipëri, Ukrainë, Armeni, Rusi)

AGON DEMJAHA

Agon Demjaha mban titullin MA në Marrëdhënjet Ndërkombëtare dhe Studime Evropiane dhe titullin PhD (Doktor Filozofie) në Shkencat Politike dhe ka mbi tre dekada përvojë në fushën e arsimit dhe hulumtimeve në insitucione të ndryshme qeveritare dhe jo-qeveritare. Gjatë viteve 2006-2010, ai ka shërbyer si Ambasador i Republikës së Maqedonisë në Mbretërinë Suedeze, duke mbuluar edhe Mbretërinë Norvegjeze dhe Republikën e Finlandës si Ambasador jo-rezident. Z.Demjaha ka qenë i angazhuar edhe si këshilltar i Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Ministrit për Zhvillim Ekonomik të Republikës së Kosovës. Aktualisht, Z.Demjaha punon si Profesor Asistent i Shkencave Politike dhe Marrëdhënjeve Ndërkombëtare në Universitetin Shtetëror të Tetovës. Ai gjithashtu jep mësim dhe është anëtar Bordi në Universitetin e Evropës Juglindore. Z.Demjaha ka botuar një numër artikujsh në fushën e shkencave politike në revista ndërkombëtare dhe është edhe autor i disa kapituj librash të redaktuara e të botuara nga shtëpi botuese të njohura siç janë United Nations University Press dhe Imperial College Press. Fushat e tij të interesit përfshijnë marrëdhënjet etnike, parandalimi dhe zgjidhja e konflikteve dhe bashkëpunimi rajonal.

Hyrje

IOANNIS ARMAKOLAS DHE JAMES KER-LINDSAY

Shpallja e Pavarësisë së Kosovës në shkurt 2008 krijoi ndasi të thella brenda Bashkimit Evropian. Përderisa 23 vende anëtare e njohën Kosovën, pesë të tjera refuzuan ta pranojnë shtetësinë e saj. Në atë kohë mendohej se edhe këto vende eventualisht do të renditeshin pas dhe do ta pranonin Kosovën. Mirëpo, edhe pas gati një dekade, kjo gjë nuk ndodhi. Përkundrazi, situata vetëm sa është bërë edhe më komplekse. Në vend të dy kampeve të ndryshme, sot ekzistojnë katër grupe. Së pari, janë vendet që e kanë njohur Kosovën dhe kanë ndërtuar raporte domethënëse me të. Këtu bëjnë pjesë Britania dhe Gjermania dhe shumë vende të tjera anëtare të BE-së. Në anën e kundërt të peshores janë shtetet që vazhdojnë ta refuzojnë njohjen e Kosovës, dhe kanë shumë pak raport me të. Spanja dhe Qiproja hyjnë në këtë kategori. Mirëpo, në mes të këtyre dy poleve janë edhe dy grupe të tjera. Për shembull, Greqia, Rumania dhe Sllovakia refuzojnë ta njohin Kosovën, por, megjithatë kanë krijuar raporte normale me Prishtinën. Ndërkohë, Republika Çeke dhe Polonia, edhe pse e kanë njohur Kosovën, në fakt, në këto dhjetë vitet e fundit, kanë pasur relativisht pak shkëmbime diplomatike me autoritetet e Kosovës.

Ky raport analizon marrëdhëniet e Kosovës me këto katër kategori të përgjithshme shtetesh. Kështu, del se edhe brenda këtyre grupeve - që me terma të përgjithshëm mund t'i quajmë 'vende njohëse dhe të angazhuara', 'njohëse dhe të paangazhuara', 'vende mos-njohëse por të angazhuara', dhe 'mos-njohëse dhe të paangazhuara' - ekzistojnë dallime të mëdha në mënyrën se si shtetet veprojnë. Për shembull, edhe ato shtete që e njohin Kosovën, dhe në të kaluarën kanë bërë shumë për ta përkrahur atë, sot mund të jenë më pak të angazhuara në krahasim me dikur. Gjithashtu, përderisa disa vende që gjithmonë kanë qenë armiqësore ndaj Kosovës, në vend se ta zbusin, vetëm sa e kanë ashpërsuar qëndrimin e tyre, disa vende të tjera kanë marrë kahje tjetër, dhe vullneti i tyre për angazhimin me Prishtinën vetëm sa është rritur. Siç vërehet, arsyet se pse vendet ndryshojnë qëndrimet e tyre, janë komplekse dhe dallojnë nga vendi në vend. Në disa raste janë reflektim i ndryshimeve të brendshme politike. Në raste të tjera, nxiten nga shqetësime të politikës së jashtme, si për shembull dëshira për t'u dukur më bashkëpunues me partnerët evropianë. Rol luan gjithashtu edhe atmos-

fera e përgjithshme politike në botë. Për shembull, pas ngjarjeve në Spanjë, shumë vende janë bërë më të matura sa i përket ndarjeve.

Ky raport tenton të gjurmoj arsyet se pse këto nëntë vende anëtare të BE-së kanë zgjedhur të mbajnë qëndrimet që kanë, dhe çfarë mund të bëj Kosova për ta rritur në mënyrë më efektive angazhimin me to. Rrjedhimisht, dy elemente të rëndësishme kanë dalë në pah. E para është se njohja, edhe pse e rëndësishme, nuk është gjithçka. Rëndësi ka edhe angazhimi. Çka është më e rëndësishme: një vend që e njeh Kosovën, por nuk ka asnjë raport me të, apo një vend që nuk e njeh, por që ruan raporte të vazhdueshme ekonomike, politike dhe sociale me Kosovën? Ndodh shpesh që i kushtohet më shumë rëndësi të parës sesa të dytës. Sigurisht që edhe njohja ka rëndësinë e vet. Mirëpo, vlera e njohjes duhet të vihet në kontekstin e duhur. Pozita e Kosovës në botë nuk matet vetëm me numra në OKB, sidomos duke e ditur se, sipas të gjitha gjasave, Rusia me të drejtën e saj të vetos do ta mbaj Kosovën jashtë OKB-së për aq kohë sa mund ta parashikojmë të ardhmen. Ndërkohë, Kosovës i duhet të krijoj shkëmbime

domethënëse me komunitetin ndërkombëtar. Cila ka më shumë vlerë për qytetarët e thjeshtë: të fitojnë edhe një pikë në tabelën e numrave, apo të përfitojnë investime nga një kompani e madhe që vjen nga një shtet që nuk i njeh?

E dyta është se angazhimi duhet menduar si spektër, dhe jo si ndarje në kategori fikse. Për shembull, vendet si Greqia, Sllovakia dhe Rumania, që nuk e njohin por janë të angazhuara, dallojnë shumë në mënyrën se si ndërveprojnë me Kosovën. Gjithashtu, duhet pasur parasysh se këto vende mund edhe të luhaten brenda këtij spektri. Nëse një shtet mban një qëndrim sot, nuk do të thotë që nuk do ta ndryshoj nesër. Angazhimi i një shteti mund të rritet, por edhe të zvogëlohet. Në vend se të mundohet dhe të kërkoj njohje nga vendet që nuk e kanë njohur, Kosova duhet t'i vlerësoj mundësitë që ka për t'i inkurajuar shtetet që të angazhohen më shumë. Në disa raste, duhet të mundohet dhe të inkurajoj vendet që ta ripërtërijnë apo ta intensifikojnë angazhimin e tyre. Ç'është më e rëndësishmja, edhe pse këtu analizohen shtetet e BE-së, shumë nga mësimet e nxjerra nga ky studim mund të aplikohen edhe në shumë vende të tjera të botës.

01 MBRETËRIA E BASHKUAR

JAMES KER-LINDSAY

Në njëzet vitet e fundit, Britania e Madhe ka qenë pa dyshim aleatja kryesore evropiane e Kosovës gjatë rrugëtimit të saj për njohje dhe pranim në rang ndërkombëtar. Duke qenë një nga shtetet që ka udhëhequr intervenimin ndërkombëtar të vitit 1999, qeveria Britanike, që nga fillimi i procesit, nuk la as më të voglin dyshim se e shihte shtetësinë e Kosovës si të vetmen zgjidhje të pranueshme - një pozitë që mbeti plotësisht e palëkundur brenda Britanisë. Kur Kosova e shpalli pavarësinë, në shkurt 2008, Britania, bashkë me Shtetet e Bashkuara, ishin të parat që provuan të

bindnin shtetet e tjera që ta njihnin Kosovën dhe t'i siguronin asaj një vend brenda organizatave të ndryshme ndërkombëtare. Falë kësaj mbështetjeje, Kosova arriti të marrë njohje nga gjysma e shteteve anëtare në Kombet e Bashkuara, duke hapur rrugë edhe për anëtarësim në disa nga organizatat më të rëndësishme ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Komitetin Ndërkombëtar Olimpik. Britania gjithashtu luajti rol të rëndësishëm në mbështetjen e Kosovës gjatë procesit të shqyrtimit juridik të ligjshmërisë së pavarësisë së Kosovës nga Gjykata Ndër-



kombëtare e Drejtësisë. Mirëpo, përderisa Britania vazhdon ta mbështes Kosovën dhe t'i përkrahë njohjet e reja sa herë që ofrohet mundësia, është mjaft e qartë që intensiteti i aktiviteteve të lobimit është ulur në këto vitet e fundit. Kjo gjë ka ndodhur për shkak të një sërë faktorësh.

Së pari, detyra për të siguruar sa më shumë njohje, është bërë tashmë jashtëzakonisht e vështirë. Siç thekson me të drejtë një zyrtar britanik “frutat e degëve të poshtme, tashmë janë vjelur”. Të gjitha shtetet që në njëfarë mënyrë kanë qenë të prirura ta njohin Kosovën, e kanë bërë këtë gjë para shumë kohësh. Rreth 80 shtetet e mbetura anëtare të Kombeve të Bashkuara që nuk e kanë njohur Kosovën, janë, pak a shumë, rastet më të vështira. Sipas këndvështrimit britanik, këto shtete mund të ndahen në katër kategori të përgjithshme. Grupi i parë janë shtetet që kundërshtojnë fuqishëm çdo lloj ndarje, dhe e shohin Kosovën si një precedent të rrezikshëm. Zhvillimet e fundit në Kurdistan dhe Kataloni vetëm sa e kanë forcuar rezistencën e këtyre shteteve për njohje. Pastaj, janë shtetet që e kundërshtojnë pavarësinë e Kosovës për arsye ideologjike. Për shembull, Rusia dhe Irani e shohin Kosovën si një lloj “projekt perëndimor”. Një grup tjetër janë vendet që hezitojnë të marrin çfarëdo lloj vendim, derisa të arrihet një zgjidhje përfundimtare mes Kosovës dhe Serbisë. Dhe, grupi i fundit, dhe mbase më i rëndësishmi për Kosovën, janë të ashtuquajturat “vendet e inercisë”. Këto janë

vende që nuk e kanë njohur Kosovën për shkak se timoni i tyre politik e diplomatik lëviz sa këndeje andej. Shumë vende, e sidomos ato në cepat e largëta të botës, dinë shumë pak për Kosovën, dhe kanë fare pak interesim për të. Nuk është se ato nuk duan ta njohin Kosovën. Thjesht nuk e kanë prioritet. Në rastet kur njohja kërkon edhe miratimin e shumicës parlamentare, Kosova mbase është viktimitë e çështjeve shumë më të rëndësishme të rendit të ditës.

Përveç vendeve që mund ta njohin Kosovën “me inerci”, të bindësh sot shtetet tjera për ta njohur Kosovën është bërë jashtëzakonisht e vështirë, nëse jo e kotë. Në disa qarqe të caktuara zyrtare britanike, mendohet se as nuk ja vlen të bësh përpjekje diplomatike për të marrë njohje nga vendet rezistente. Në fakt, përpjekjet aktive mund ta dëmtojnë pozitën e Britanisë në botë. Pas përpjekjeve të vazhdueshme për të bindur vendet e tjera që ta njohin Kosovën, ideja se Londra po vazhdon ta bëjë këtë gjë, por zëri i saj po injorohet, shkon në dëm të imazhit të Britanisë. Mbi të gjitha, ky qëndrim duket se është gjithnjë e më i përhapur. Anëtarët e tjerë të Kunitit - pesë shtetet perëndimore të ngarkuara me detyrën për ta mbikqyrë tranzicionin e Kosovës deri në statusin e saj final - si duket kanë vënë re të njëjtën gjë. Siç raportohet t'u ketë thënë një diplomat vendeve të tjera anëtare në grup, dështimi për të marrë njohje të reja “po bëhet e sikletshme”. Por, kjo nuk do të thotë se situata do të mbetet e njëjtë



nëse rrethanat ndryshojnë. Për shembull, nëse një vend jep sinjale se mund të jetë i hapur ta njoh Kosovën, në këtë rast Britania do ta ketë vullnetin të asistoj. Kjo lloj mbështetje është e rëndësishme sidomos nëse bëhet fjalë për një nga anëtarët e Komonuelthit.

Nën dy, politika e brendshme e viteve të fundit në Kosovë i ka dëmtuar tejmasë përpjekjet për njohje. Zyrtarët britanikë e shprehin frustrimin e tyre në lidhje me mënyrën se si politikanët në Kosovë i kanë nënvlerësuar përpjekjet për të siguruar njohje të mëtutjeshme ndërkombëtare. Përçarjet në parlament, me partitë opozitare duke hedhur deri edhe gaz lotsjellës, kanë qenë të dëmshme në veçanti. Këto imazhe u panë në gjithë botën. Ishte një katastrofë për marrëdhëniet me jashtë. Siç theksonin zyrtarët britanikë, ata nuk mund të thonë se Kosova ka arritur të jetë një vend stabil e me demokraci funksionale, kur imazhet e demonstratave, përleshjeve publike me policinë si dhe e deputetëve me maska gazi, transmetohen nga medime ndërkombëtare lajmesh. Edhe pse situata është duke u përmirësuar, është mëse e sigurtë se destabiliteti politik i viteve të fundit i ka kush-tuar njohjeve të reja të Kosovës, dhe e ka bërë më të vështirë për përkrahësit e Kosovës që t'i bindin vendet e tjera ta njohin statusin e pavarur të saj.

E treta, pas gati dhjetë vitësh nga deklarata e pavarësisë, dhe për shkak se ata besojnë se Britania nuk mund të vazhdojë të mbaj rol

qëndror në përpjekjet për ti bindur të tjerët ta pranojnë Kosovën, zyrtarët britanikë besojnë se është jetike që Kosova të shihet se po e merr rolin udhëheqës në të ardhmen. Përsëri, kjo nuk do të thotë se Britania nuk është më e gatshme për të luajtur rol në përpjekjet për t'i bindë të tjerët që ta njohin Kosovën ose të sigurojë anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Do ta bëjë këtë sa herë që të ketë mundësi. Në vend të kësaj, qeveria britanike dëshiron të lëvizë drejt një roli më mbështetës. Kosova duhet të dalë jashtë dhe të marrë vetë përsipër këto veprime.

Dhe në fund, të gjithë këta faktorë po ndodhin në një ambient ndërkombëtar që po ndryshon me shpejtësi të madhe. Përderisa Kosova dikur ka qenë në krye të agjendës së politikës së jashtme të Britanisë, perspektiva e mundshme e daljes së Britanisë nga Bashkimi Evropian, ngre disa pyetje të rëndësishme sa i përket drejtimit që do të marrë politika e jashtme britanike në të ardhmen. Fokusi i Londrës në Kosovë, apo edhe rajonin e gjerë të Ballkanit, me gjasë do të shkoj duke u zbehur. Megjithë suksesin e këngëtarëve tashmë yje të famshme siç janë Rita Ora dhe Dua Lipa, Britania nuk ka lidhje të forta me Kosovën. Sipas censusit të fundit të vitit 2011, numri i njerëzve të lindur në Kosovë që jetojnë në Britani është 28,000. Ky numër është shumë i vogël, sidomos në terma relativ. Sa për krahasim, në Britani jetojnë pothuajse 600,000 polakë. Gjithashtu, marrëdhëniet ekonomike janë minimale. Të dhënat e fundit britanike



tregojnë se Kosova është renditur në listë si vendi i 177-të si burim importesh dhe vendi 179-të si destinacion eksportesh. Përderisa vëmendja e Britanisë është orientuar drejt marrëdhënieve tregtare me ekonomitë e mëdha botërore, si Shtetet e Bashkuara apo Kina, ose vendeve me të cilat ka lidhje të forta historike, siç janë vendet e Komonuelthit, vëmendja që do t'i dedikohet Kosovës, apo edhe Ballkanit Perëndimor në përgjithësi, me siguri se do të zvogëlohet. Është e sigurtë se shumë zyrtarë britanikë janë të mendimit se Kosova mbetet një çështje e rëndësishme e sigurisë. Mirëpo, edhe në këtë aspekt, Kosova nuk është e renditur lart në terma global. Ka edhe të tjerë që janë të mendimit se është Bashkimi Evropian ai që duhet të luaj rol më të madh në këtë rajon.

Në përgjithësi, Britania mbetet një përkrahëse solide e pavarësisë së Kosovës. Mirëpo, dëshira për të lobuar në vendet e treta për njohjen e Kosovës, apo për ta pranuar Kosovën në organizata ndërkombëtare, pa dyshim se është zbehur në vitet e fundit. Përderisa sukcesi i njohjeve të para ka stagnuar, politikbërësit britanikë kanë filluar të besojnë se lobimi tjetër rigoroz e zbehë qëndrimin e Mbretërisë së Bashkuar. Kjo gjë vështirë se do të ndryshoj në të ardhmen. Përveç tjerash, Britania do të jetë aq e fokusuar te Brexit-i, sa nuk do të mund të vazhdojë të luaj të njëjtin rol aktiv lobimi për njohjen e Kosovës, siç ka vepruar dikur. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se nuk është e gatshme të ndihmojë. Ajo do të ndihmojë

aty ku dhe kur ka mundësi. Për këtë arsye, qeveria e Kosovës duhet ta marrë përsipër procesin e aktiviteve për njohje të reja. Duke dëshmuar se ka një plan konkret veprimi, që fokusohet ndoshta në ato vende që kanë mbetur mbrapa për shkak të proceseve të tyre të ngadalshme politike, dhe pastaj të kërkojë përkrahje aty ku mendon se Britania mund të ndihmojë. Por mbi të gjitha, Kosova duhet t'u ofroj mbështetësve të saj kryesor argumentin më të mirë të mundshëm për t'i bindur vendet që nuk e ka njohur se është një shoqëri stabile dhe demokratike dhe duhet të njihet botërisht si anëtare e komunitetit ndërkombëtar.

02 GJERMANIA

JULIA HIMMRICH

Roli gjithnjë e më i madh i Gjermanisë në çështjet evropiane e botërore e ka bërë atë një prej aktorëve kryesorë në Ballkanin Perëndimor. Për shkak se vëmendja nga Shtetet e Bashkuara ka rënë, ndërsa ndikimi i Mbretërisë së Bashkuar është zvogëluar si pasojë e Brexit-it, roli i Gjermanisë në rajon mund të vazhdojë të rritet. Kjo vetëm sa e ka vendosur lidhësin gjerman në marrëdhëniet Kosovë-Serbi dhe në përgatitjen e rajonit për t'u bërë pjesë e BE-së nëpërmjet Procesit të Berlinit. Për Gjermaninë, mbështetja e shtetësisë së Kosovës është

pjesë e strategjisë së saj për të vendosur stabilitet në Ballkanin Perëndimor si dhe në procesin e gjërë të integritimit.

Gjermania e ka mbështetur vazhdimisht shtetësinë e Kosovës, që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008. Ajo është angazhuar që Kosova të marrë sa më shumë njohje bilaterale dhe anëtarësime në organizata ndëkombëtare. Politikanët gjermanë ushtrojnë në mënyrë të hapur presion mbi Serbinë për të bërë progres të normalizimit. Në kuadër të Bashkimit Evropian, Gjermania punon nga afër me pesë vendet që nuk e kanë njohur



Kosovën që t'i mundësojnë asaj të ketë një perspektivë evropiane.

Gjermania ka qenë pjesë e negociatave më të rëndësishme për Kosovën qysh në vitet 1990-të. Edhe pse roli i saj fillimisht ka qenë i kufizuar, me kohë Gjermania është kthyer në një aktor të rëndësishëm, dhe konsiderohet si vend që arrin të krijoj ura me Serbinë dhe Rusinë. Pjesëmarrja në intervenimet e NATO-s në vitin 1999 ishte një vendim që u konsiderua kontravers brenda Gjermanisë, mirëpo Gjermania vazhdon t'i ofroj NATO-s kontigjentin më të madh në Evropë. Gjithashtu, Gjermania ka shtruar themelet e integritit Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor duke e filluar Paktin e Stabilitetit për Evropën Jug-Lindore në vitin 1999. Së bashku me Italinë, Gjermania ka luajtur rol kritik gjatë procesit të Ahtisarit kur nuk arriti t'i mernte në konsideratë kërkesat e serbëve dhe e armiqësoi lider-shipin në Beograd. Kur u mor vendimi për ti zgjatur negociatat e statusit, diplomati gjerman, Wolfgang Ischinger, u emërua përfaqësues i BE-së dhe kryesues i Trojkës bashkë me SHBA-të dhe Rusinë. Edhe negociatat e Trojkës dështuan në arritjen e një marrëveshjeje. Megjithatë, për shkak të angazhimit të kryesuesit me disa vende anëtare të BE-së, Kosova arriti të siguronte më shumë njohje nga BE-ja, ndërsa pesë vendet që nuk e njohën u pajtuan që të gjenin kompromis dhe të vendosej misioni i EULEX-it me mandat “neutral mbi

statusin”. Në këtë mënyrë, roli i Gjermanisë ishte instrumental për marrjen e një numri sa më të madh njohjesh nga vendet anëtare të BE-së dhe të sigurohej roli i BE-së në Kosovë, pavarësisht mospajtimeve mes vendeve të BE-së sa i përket statusit. Edhe hezitimi i disa partive politike gjermane u tejkalua nëpërmjet negociatave të Trojkë dhe pas njohjes, Gjermania u bë publikisht kampioni më i zëshëm në mbrojtje të shtetësisë së Kosovës.

Që nga viti 2008, Gjermania ka patur disa koalicione qeverisëse nën udhëheqjen e Kancelares Merkel, por qëndrimi ndaj shtetësisë së Kosovës ka mbetur konsistent. Si kundërpërgjigje ndaj kërkesës së Serbisë për Mendim Këshillues nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, Gjermania i koordinoi kontributet e vendeve anëtarë të BE-së që e kishin njohur Kosovën, për të siguruar përfaqësimin më të mirë të mundshëm në favor të Kosovës. Pas vendimit të Gjykatës, politikanët gjermanë u shprehën edhe më fuqishëm në mbështetje të pavarësisë së Kosovës. Në vitin 2011, Kancelarja Merkel ishte e vetmja lidere e huaj që kërkoi shpërbërjen e strukturave paralele serbe në veri të Kosovës. Në vitin 2012 anëtarët e CDU-së në Parlamentin Gjerman e vizituan Beogradin duke thënë se Gjermania do ta pengonte progresin e procesit të pranimit të Serbisë në BE pa njohjen e Kosovës. Ky lloj presioni nga disa parlamentarë gjermanë ka vazhduar me vite, edhe pse nuk është



qëndrim zyrtar i qeverisë. Marrëdhëniet me Serbinë u përkeqësuan dhe Gjermania u pozicionua si ndërmjetësuese e ashpër në mbështetje të shtetësisë së Kosovës, duke luajtur ndërkohë edhe rol kyç në procesin e pranimit të Serbisë në BE. Edhe pse këto marrëdhënie u përmirësuan gjatë mandatit qeverisës të Kryeministrit/Presidentit Vuçiq, Gjermania insiston në vazhdimin e diskutimit të progresit të normalizimit si pjesë e bisedimeve me Serbinë për pranim në BE, dhe kërkon nga Serbia që ta hapë, sa më parë që është e mundur, kapitullin 35 të acquis mbi marrëdhëniet e ardhshme me Kosovën. Brenda Procesit të Berlinit, Gjermania e ka vendosur Kosovën si partner të barabartë me shtetet e saja fqinje, dhe sa për ilustrim, ky është forumi i parë ku në mesin e shteteve të tjera të Ballkanit Perendimor është shfaqur edhe flamuri i Kosovës.

Për të përfituar sa më shumë njohje ndërkombëtare, Gjermania ka koordinuar qeverinë e Kosovës dhe shtetet aleate si SHBA-të dhe vendet e BE-së. Mirëpo, për të mos e armiqësuar edhe më shumë Rusinë, fokusi i saj ka mbetur në Evropë. Më vonë është kthyer kah vendet të cilat nuk kishin ndonjë qëndrim të fortë pro apo kundër Kosovës së pavarur. Për këtë, sa herë që është dhënë mundësia, Gjermania e ka përfshirë çështjen e shtetësisë së Kosovës në diskutime bilaterale. Pas valës së parë të njohjeve bilaterale, Gjermania është angazhuar për të

punuar nga afër me udhëheqësit në Kosovë për të arritur pranimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare. Këtu hyjnë organizatat e mëdha ndërkombëtare, si dhe institucionet sociale dhe sportive. Për shkak se Gjermania është lidere e fuqishme rajonale dhe një nga kontribuesit më të mëdhenj financiar në organizata shumëpalëshe, ajo ka qenë në gjendje të mobilizoj mbështetje.

Gjermania vazhdon të jetë e përkushtuar në mbështetjen ndaj Kosovës për të fituar sa më shumë njohje dhe anëtarësime në organizata ndërkombëtare. Mirëpo, realiteti i numrit gjithnjë e më të vogël të shteteve që potencialisht mund ta njohin Kosovën si dhe progresi i avashtë i dialogut Beograd-Prishtinë, i bën përpjekjet e lobimit edhe më të vështira. Në këtë kontekst, roli i udhëheqësve të Kosovës po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm, tani që e ardhmja e procesit të njohjeve dhe në veçanti e pranimit në organizata ndërkombëtare varet nga një strategji efektive e qeverisë kosovare. Sa i përket vështirësive të fundit për t'u anëtarësuar në UNESCO dhe Interpol, politikbërësit gjermanë potencojnë rrethanat ndërkombëtare, por edhe llogaritë e gabuara nga ana e qeverisë së Kosovës. Në rastin e UNESCO-s, sipas këndvështrimit të politikbërësve gjermanë, Kosova nuk e kishte arritur mbrojtjen e vendeve të trashëgimisë kulturore dhe, për këtë arsye, po aplikonte nga një pozitë jo e favorshme. Vendimi i Kosovës për të kërkuar anëtarë-



sim pavarësisht kësaj, ishte befasuese. Koha dhe kapacitetet e kufizuara për shkak të negociatave mes koalicioneve e bëri të pamundur përpjekjen e domosdoshme për të lobuar. Anëtarësimi në UNESCO në të ardhmen mund të jetë edhe më i vështirë pas daljes së Shteteve të Bashkuara nga organizata, që e bën Kosovën ta humbas mbështetësin më të fuqishëm. Sa i përket Interpol-it, sipas politikbërësve gjermanë, anëtarësimi ishte i vështirë kryesisht për shkak të rolit të Republikës Popullore të Kinës, vend ky që nuk e ka njohur Kosovën, si vend mikpritës. Për shkak të pamundësisë së kosovarëve për të udhëtuar në Kinë dhe për t'u përfshirë në aktivitete lobuese atje, ata realisht nuk kishin asnjë mundësi për t'u angazhuar me vendet anëtare atje, diçka që vendet partnere të Kosovës nuk mund ta bëjnë. Politikbërësit gjermanë shpresojnë se në takimin e ardhshëm të përgjithshëm vjetor në Dubai në Emiratet e Bashkuara Arabe, vend ky që e ka njohur dhe mbështetur Kosovën, qeveria kosovare do të ketë mjaftueshëm kohë për të lobuar me sukses dhe të koordinohet nga afër me partnerët.

Sipas këndvështrimit gjerman, zhvillimi socio-politik dhe ekonomik i Kosovës është i lidhur ngusht me numrin sa më të madh të njohjeve si dhe me anëtarësimin në organizata ndërkombëtare. Kosova duhet të bëhet gjithnjë e më atraktive si një partner ndërkombëtar, duke treguar rezultate në

reformat e premtuara. Kjo gjë ndërlihet, sipas politikbërësve gjermanë, me një sërë problemesh më të gjëra në kuadër të integritit në BE, siç janë progresi i demarkacionit të kufirit me Malin e Zi si dhe lufta kundër krimit të organizuar, që janë prioritetet imediate për të arritur liberalizimin e vizave. Një nga aspektet kryesore të kësaj është edhe normalizimi i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Nëse ka përmirësim të raportit me Serbinë, njohja e Kosovës për vendet e treta nuk do shihet më si një akt armiqësor apo i rrezikshëm.

Për shkak të forcimit të rolit të saj në Bashkimin Evropian, Gjermania mbetet aleate kyçe për Kosovën brenda Bashkimit Evropian. Gjatë dhjetë viteve të fundit, Gjermania ka qenë edhe mbrojtëse aktive e pavarësisë së Kosovës dhe e njohjes së saj. Për Gjermaninë, shtetësia e plotë e Kosovës lidhet drejtpërdrejtë me stabilitetin në Ballkanin Perëndimor dhe është një nga aspektet e strategjisë së saj për integrim rajonal. Gjermania ka shpenzuar kapital të konsiderueshëm politik në mënyrë që anëtarët e BE-së të vazhdojnë bashkëpunimin, pavarësisht mospajtimeve të tyre në lidhje me statusin e Kosovës dhe me mungesën e interesit për zgjerim. Për këtë arsye fokusi është përqendruar në reforma politike dhe Gjermania me gjasë nuk do ta lejoj asnjë nga vendet candidate për BE në rajon që të bëjnë lëshime para se të hyjnë në BE. Pavarësisht presionit të madh që Gjermania



mund të ushtroj mbi Serbinë që ta mbaj të angazhuar dhe konstruktive në raport me Kosovën, Gjermania do të vazhdoj të jetë e rreptë edhe në kushtet e vendosura ndaj Kosovës, siç është rasti i liberalizimit të vizave. Sa i përket strategjisë së saj ndërkombëtare për njohje të mëtutjeshme, Kosova mund të llogaris në mbështetjen nga Gjermania. Qeveria e Kosovës duhet të ofroj një strategji të qartë dhe konsistente që vlerëson të gjitha rreziqet para aplikimeve. Sipas politkbërësve gjerman, rasti i UNESCO-s e ka dëmtuar “markën” kosovare dhe perspektivën e saj për anëtarësim në organizata të tjera. Bashkëpunimi i

ngushtë me anëtarë të organizatës të cilët mund të veprojnë si sponsor është thelbësor, ashtu siç është edhe sigurimi i kohës së mjaftueshme. Një aplikim i tillë për Interpol në vitin 2018 do të rezultonte i suksesshëm. Njohje të reja të plota bilaterale nuk duket se do të ketë në të ardhmen e afërt, ndërsa Serbia vazhdon me fushatën e saj kundër njohjeve. Kosova duhet të prezantohet si partnere e rëndësishme dhe tërheqëse në mënyrë që të nxisë angazhime ekonomike dhe sociale me partnerë të rinj, edhe nëse nuk është në gjendje të arrijë njohjen e plotë diplomatike.

03 REPUBLIKA ÇEKE

TOMÁŠ DOPITA

Marrëdhënjet mes Republikës Çeke dhe Kosovës së pavarur kanë qenë të komplikuar, por kanë potencial të madh për përmirësim. Për ata që e shohin nga jashtë, situata mund të jetë e vështirë për t'u kuptuar. Edhe pse qeveria çeke e ka njohur pavarësinë e Kosovës në fund të muajit maj 2008, Presidenti Václav Klaus nuk u pajtua me këtë vendim dhe refuzoi që të emëronte një ambasador çek në Prishtinë. Por, Ministri i Jashtëm Schwarzenberg veprroi kundër vullnetit të Presidentit duke marrë përsipër që ministria e tij të krijonte marrëdhënie diplomatike me Republikën e

Kosovës duke e kthyer Zyrën Ndërlidhëse Çeke në UNMIK, në Ambasadë të Republikës Çeke. Schwarzenberg gjithashtu emëroi një *chargés d'affaires* për të udhëhequr ambasadën. Edhe pse kjo situatë është e pazakonshme, është larg të qenurit unike. Kjo lloj kontradikte është "shënjuese" e politikës së jashtme çeke kundrejt Kosovës së pavarur. Por, si është i mundur ky kombinim i njohjes dhe i mosangazhimit? Të kuptosh se ku e ka burimin kjo kontradiktë, është një nga parakushtet e domosdoshme për të menduar se si mund të përmirësohen në të ardhmen marrëdhënjet Çeki-Kosovë.



Nga njëra anë, është e rëndësishme të kuptohet se populli çek ndjen një afërsi kulturore me popujt sllav në Ballkan, dhe se ka një marrëdhënie të veçantë shumë-vjeçare me kombin serb, që nga koha e lëvizjes pan-sllave në shekullin XIX. Ndërsa, sa për krahësim, deri në vitet 90-të, sferat kulturore, politike dhe ekonomike çeke dhe shqiptare (në Kosovë) nuk kishin pothuajse asgjë të përbashkët. Përkundrazi, shqiptarët ishin asociuar negativisht si ‘otomanë’, ‘turq’ apo ‘muhamedianë’. Në këtë kontekst, ata shiheshin si pushtues simbolik të sllavëve dhe të krishterëve në Evropën Juglindore. Në vitin 1993, Kosova u përmend në parlamentin çek si një tjetër “problem potencial sigurie” në Evropën Juglindore, ndërsa shqiptarët si ‘komb militant’.

Në anën tjetër, është tejet e rëndësishme të kuptohet gjithashtu se, pas rënjes së regjimit komunist në vitin 1989, Republika Çeke kaloi një tranzicion gjeopolitik nga Lindja drejt Perëndimit dhe politika e jashtme e qeverive çeke ishte pothuajse gjithmonë në të njëjtën linjë me vendet e tjera të mëdha demokratiko-liberale perëndimore. Këto vende kanë qenë arkitektët themelorë të pavarësisë së Kosovës, dhe kanë ushtruar ndikim të madh mbi vendet e tjera, përfshirë Republikën e Çekisë, për ta njohur Kosovën si shtet të pavarur.

Kontradikta e marrëdhënies së Çekisë me Kosovën është e mbërthyer pikërisht në kombinimin e sentimentit kombëtar pro-serb

dhe orientimit gjeopolitik pro-perëndimor. Rrjedhimisht, shumë politikanë çek kanë qenë të prirur ta përkrahin çështjen nacionale serbe, por janë tërhequr në momentin që janë ballafaquar me aleatët e tyre perëndimor. Për shembull, në vitin 2013, kur Milosh Zeman u zgjodh President i Republikës së Çekisë, ai e ndoqi politikën e Klausit për mosangazhim dhe refuzoi që të shtynte përpara marrëdhëniet diplomatike çeko-kosovare në nivel ambasadash. Mirëpo, në vitin 1999, ishte qeveria e të njëjtit Milosh Zeman që iu nënshtrua presionit perëndimor dhe aprovoi sulmet ajrore të NATO-s. Një kombinim i ngjashëm i qëndrimit pro-serb të Çekisë dhe presionit ndërkombëtar, ishte arsyeja pse qeveria çeke vendosi ta njihte pavarësinë e Kosovës. Në fakt, tentimi i parë për ta njohur Kosovën dështoi, kur Partia Demokristiane haptas e vuri në dyshim statusin ligjor të pavarësisë së Kosovës. Si përfundim, qeveria e njohu Kosovën gjatë një seance të veçantë në qytetin e Teplicës, pa ndonjë paralajmërim. Edhe atëherë, nga 18 anëtarë të kabinetit, vetëm 11 prej tyre e përkrahën këtë vendim.

Kështu, kontradikta e marrëdhënies së Çekisë me Kosovën është pasojë e kombinimit të sentimentit pro-serb brenda Çekisë dhe ndikimit Perëndimor mbi politikën e jashtme çeke. Mirëpo, është interesante që një kontradiktë e tillë nuk përputhet me asnjë nga ndarjet e tjera ideologjike, politike apo gjeopolitike në skenën politike çeke. Mirëpo, në terma real, kjo ndarje ka arritur të krijoj dy



grupe kryesore aktorësh, marrëdhënia e të cilëve me Kosovën e pavarur ka qenë mjaft kontradiktore. Fillimisht, kampi pro-perëndimor është udhëhequr nga Václav Havel, që ishte President i Çekosllovakisë dhe më pas i Republikës Çeke nga viti 1989 deri në vitin 2003. Më vonë, kjo qasje ndaj Kosovës është përfaqësuar kryesisht nga Karel Schwarzenberg, i cili punoi me Havelin, dhe ishte Ministër i Jashtëm gjatë periudhës 2007-2009 dhe 2010-2013. Agjenda ditore pro-perëndimore është implementuar kryesisht nga shërbimi i jashtëm çek, që ka qenë në mënyrë konsistente pro-perëndimor në qasjen ndaj Kosovës, dhe vazhdon të jetë i tillë edhe sot. Ndërkohë, grupi pro-serb është përfaqësuar në fillim kryesisht nga Václav Klaus, rivali politik i Havelit i cili ka mbajtur disa poste të rëndësishme politike (Kryeministër i Çekisë gjatë 1992-1998, Kryetar i Dhomës së Deputetëve gjatë viteve 1998-2002, dhe President i Çekisë në periudhën 2003-2013). Mirëpo, ky kamp ka patur dhe ka edhe sot figura të tjera të rëndësishme që vinë nga parti të ndryshme politike, siç janë Jiří Dientsbier (Ministër i Jashtëm i Çekosllovakisë në vitet 1989-1992), Jan Kavan (Ministër i Jashtëm i Çekisë në vitet 1998-2000, Partia Demokristiane) Lubomír Zaorálek (Ministër i Jashtëm i Çekisë në vitet 2014-2017, Partia Social Demokrate), Jaroslav Foldyna (Deputet i Partisë Social Demokrate që nga viti 2010), Vojtěch Filip (Kryetar i Partisë Komuniste Çeke që nga viti 2005), dhe shumë të tjerë.

Është e rëndësishme të përmendet se, në vijim të faktit që ky mospajtim nuk përkon me ndasitë e tjera kryesore të etabluara në politikën çeke, shumë prej këtyre aktorëve pro-serb janë në të njëjtën kohë edhe tejet pro-perëndimor.

Nga këndvështrimi i Kosovës, mund të duket sikur ndikimi perëndimor në politikën e jashtme çeke ka qenë i dobishëm dhe se qasja pro-perëndimore ndaj Kosovës duhet të forcohet dhe të zhvillohet edhe më shumë. Mirëpo, duhet kuptuar se njohja e pavarësisë së Kosovës nga qeveria çeke ka qenë mbase arritja e parë dhe e fundit e rëndësishme e qasjes pro-perëndimore ndaj Kosovës. Procesi që i ka paraprirë njohjes së pavarësisë së Kosovës nga Çekia, i ka bërë bashkë të gjithë aktorët politik pro-serb që vinë nga segmente të ndryshme të skenës politike çeke. Këta aktorë më pas janë munduar që të pengojnë çfarëdo lloj angazhimi me Kosovën si shtet sovran. Për këtë arsye, potenciali i qasjes pro-perëndimore ndaj Kosovës, mbase tashmë është shpenzuar. Ashtu siç qëndrojnë gjërat sot, mbështetësit perëndimorë të Kosovës nuk kanë asnjë instrument për ta forcuar angazhimin social, politik dhe ekonomik mes Republikës së Çekisë dhe Republikës së Kosovës.

E vetmja gjë që këto dy kampe kanë të përbashkët është se asnjëra nga to nuk e vlerëson Kosovën në vetvete, në ndonjë formë të mirëfilltë. Aktorët e politikës së



jashtme çeke i kanë aprovuar sulmet ajrore të NATO-s dhe e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, kryesisht për shkak të partnerëve të tyre në Perëndim, dhe jo për shkak se kanë pasur ndonjë ndjeshmëri të madhe ndaj situatës në Kosovë. Në këtë kontekst, si duket, përveç shërbimit diplomatik, marrëdhënia aktuale mes Çekisë dhe Kosovës është pothuajse joekzistente dhe nuk ka shkëmbim të mirëfilltë mes këtyre dy vendeve dhe popujve. Shqetësues është edhe fakti se angazhimi i Kosovës ndaj Çekisë vuan nga po i njëjti problem, në mos më shumë. Për shembull, ambasada e Kosovës në Pragë nuk prodhon për vendasit asnjë dokument me përmbajtje në gjuhën çeke apo angleze. Kjo mangësi do të thotë se politikanët apo gazetarët çekë nuk mund të flasin më fuqishëm për Kosovën, edhe nëse duan të bëjnë një gjë të tillë. Në anën tjetër, ambasada çeke në Prishtinë poston çdo javë gjëra në gjuhën shqipe. Një tjetër problem që e potencojnë zyrtarët çekë është se kolegët e tyre kosovarë fokusohen vetëm tek çështjet që kanë të bëjnë me njohjet dhe statusin ndërkombëtar. Sipas zyrtarëve çekë, kjo qasje një-dimensionale shpesh e ka rrezikuar suksesin e iniciativave të tjera.

Në përgjithësi, ekziston një kundërthënie mes qasjes pro-perëndimore dhe asaj pro-serbe, që e karakterizon marrëdhënien aktuale mes Çekisë dhe Kosovës. Në të njëjtën kohë, duket sikur Kosovës i interesojnë vetëm çështjet që kanë të bëjnë me diplomacinë ndërkombëtare dhe me njohjet.

Bazuar në situatatën aktuale, kushtet për të pasur angazhim dhe bashkëpunim në të ardhmen nuk duken të favorshme. Për të krijuar më shumë hapësira që lejojnë shkëmbim të mirëfilltë mes dy vendeve, Kosova duhet të shoh përtej politikës që mendon vetëm për çështjet që kanë të bëjnë me statusin ndërkombëtar. Është qenësore që Kosova ta zhvillojë aftësinë për të prodhuar përmbajtje origjinale që i përshtaten kontekstit çek dhe të fillojë të angazhohet edhe me publikun e gjerë, përtej shërbimeve të huaja çeke. Në këtë kontekst, Kosova mund ta përdorë edhe qëndrimin pro-serb të Çekisë në favor të saj. Për shembull, një hap që do të mund të kishte ndikim do të ishte emërimi i një serbi nga Kosova si ambasador i ardhshëm në Pragë. Gjithashtu, Kosova mund të përdorë çështjet me interes të përbashkët, siç është procesi i zgjerimit të BE-së, për t'u angazhuar më nga afër me aktorët politik në Republikën Çeke. Dhe në fund, diplomatët dhe zyrtarët kosovarë duhet të artikulojnë qëndrimin e tyre politik dhe publik se pse është e rëndësishme që Republika e Çekisë dhe Kosova të arrijnë një nivel më të lartë angazhimi. Kjo gjë është kritike, sepse për shkak të strukturës së re politike pas zgjedhjeve të përgjithshme të 2017-tës dhe zgjedhjeve presidenciale në Janar 2018, marrëdhënjet me Kosovën, edhe një herë, mund të kthehen në një nga çështjet më të kontestuara publike dhe politike. Në rast se ndodh një gjë e tillë, përfaqësuesit e Kosovës duhet të jenë të gatshëm ta mbrojnë argumentin e tyre në favor të Kosovës.

04 POLONIA

JAROSLAW WISNIEWSKI

Politika e Polonisë ndaj Evropës Juglindore fokusohet në dy fusha: zgjerimi i BE-së dhe siguria. Këto të dyja në fakt ndërliidhen. Parë nga një perspektivë strategjike dhe afatgjate, hyrja në BE e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (6BP) shihet si rritje e sigurisë për gjithë kontinentin. Megjithatë, ky rajon akoma nuk është prioritet për politikën polake. Gjithashtu, marrëdhëniet me vendet e veçanta të Evropës Juglindore nuk kanë prioritet të barabartë. Nga të gjitha vendet e 6BP, partneri kryesor i Polonisë është Serbia. Kjo gjë ka ndikuar shumë në mënyrën se si Varshava i qaset raportit me Prishtinën.

Polonia nuk është ndonjë mbështetëse e flaktë e pavarësisë së Kosovës, edhe pse e ka njohur atë më 26 shkurt 2008, vetëm një javë pas shpalljes zyrtare të pavarësisë. Këshilli i Ministrave shqyrtoi katër mundësitë e rekomanduara nga Ministria e Punëve të Jashtme: (1) njohje e menjëherëshme; (2) mos-njohje; (3) të pritët se si do të zhvillohet situata dhe më pas njohje; (4) njohje por pa krijuar marrëdhënie diplomatike. Fillimisht, qeveria - një koalicion i Platformës Qytetare dhe Partisë Fshatare - dëshironte të ishte një nga njohësit e parë (thuhet për shkak të presionit të madh nga Uashingtoni). Mirëpo,



njohja hasi në rezistencë të hapur dhe të drejtpërdrejtë nga Pallati Presidencial. Presidenti i Polonisë shqetësohej për ndikimin që kjo njohje do të kishte në provincat separatiste të ish-Bashkimit Sovjetik, më saktë Abkhazisë, Osetisë Jugore dhe Transnistrisë. Një aspekt i rëndësishëm i këtij mospajtimi ishte edhe konflikti personal mes Kryeministrit Donald Tusk dhe Ministrit të Jashtëm Radosław Sikorski në njërën anë, dhe Presidentit Lech Kaczyński në anën tjetër. Tusk dhe Sikorski ishin dy nga përkrahësit kryesorë të pavarësisë së Kosovës. Nga ana kushtetuese, kërkohej që presidenti të nënshkruante vendimin. Si përfundim, u vendos që të arrihej një kompromis, i pranueshëm për Presidentin - njohje, por jo marrëdhënie të drejtpërdrejta diplomatike. E rëndësishme të ceket se politika e Polonisë ndaj Kosovës nuk ka pasur ndonjë ndikim negativ në marrëdhëniet bilaterale me Serbinë.

Këto qëndrime kundërthënëse kanë mbizotëruar gjatë nëntë viteve që pasuan, duke ndikuar në lidhjet mes Polonisë dhe Kosovës. Kemi së paku dy shembuj që ilustrojnë qasjen jokonsistente të Polonisë ndaj Kosovës - debati mbi hapjen e një Zyrë Tregare/Ambasade dhe abstenimi nga votimi për hyrjen e Kosovës në UNESCO. Në periudhën mes gjysmës së vitit 2010, kur Bronisław Komorowski i Platformës Qytetare u shpall President i Polonisë, dhe fundit të vitit 2014, kur Donald Tusk e la postin e Kryeministrit për t'u bërë President i Këshillit të Europës, qeveria debatoi disa herë

për ta kthyer mbrapsht vendimin fillestar dhe të krijoheshin marrëdhënie të drejtpërdrejta diplomatike. Kjo temë raportohet të jetë diskutuar nga Këshilli i Ministrave së paku dy herë, dhe të dyja herët nuk është gjetur 'momenti i përshtatshëm' (p.sh. vizita rajonale nga Presidenti). Ky mendim u braktis në momentin që Ewa Kopacz e mori vendin e Tusk-ut dhe u bë kryeministre. Momenti i dytë ishte gjatë aplikimit të Kosovës për UNESCO, dhe abstenimi i Polonisë. Polonia e bazoi vendimin e saj në këto tre premisa: anëtarësimi i Kosovës në UNESCO mund të pengonte dialogun mes Beogradit dhe Prishtinës; UNESCO po ballafaqohej me vendime të rëndësishme në lidhje me aktivitetet dhe financimet në të ardhmen; dhe, anëtarësimi i Kosovës do të politizonte punën e saj. Pikë reference ishte edhe aplikimi i Palestinës për UNESCO në vitin 2011, ku Polonia abstenoj. Megjithatë, Polonia e konsideron veten si përkrahëse të shtetësisë së Kosovës, dhe se abstenimi nga votimi nuk e ka ndikuar aspak këtë qëndrim.

Në terma praktik, mungesa e lidhjeve të drejtpërdrejta diplomatike do të thotë se bashkëpunimi mes Polonisë dhe Kosovës ndodhi kryesisht në nivele shumëpalëshe; bashkëpunimi bilateral mbeti në nivele të ulta (p.sh. konsultime të rregullta të MPJ-ve në nivel drejtorësh). Megjithatë, Polonia e vazhdon prezencën dhe mbështetjen e drejtpërdrejtë ndaj Kosovës. Për shembull, Kontigjenti Usharak Polak në kuadër të KFOR-it ka qenë në Kosovë që nga viti 1999, dhe është i stacionuar



në Novo Sellë. Po ashtu, një Njësi Speciale e Policisë Polake operon në Mitrovicë.

Që nga viti 2015, qasja e politikës së jashtme të qeverisë së re Ligj dhe Drejtësi, është dukshëm e ndryshme nga ajo e qeverive të mëparshme. Marrëdhënja e ngushtë me Gjermaninë, që ishte karakteristikë e viteve të mëhershme, në një masë të madhe u braktis. Në vend të kësaj, vëmendja u fokusua drejt bashkëpunimit më të afërt rajonal - kryesisht me Grupin e Vishegradit, apo V4. Fillimisht pati një agjendë ambicioze politike për t'u fokusuar tek aksi Veri-Përendimor, që do ta rriste praninë e Polonisë në Evropën Juglindore (bashkëpunim më i afërt me Shqipërinë, Kroacinë, Serbinë, mbështetje më e madhe për Bosnje dhe Hercegovinën, përderisa Kosova nuk përmendej pothuajse fare në këtë debat). Por kjo ndaloi pas eskalimit të situatës në Ukrainë me Euromaidanin e vitit 2014. Politikanët megjithatë nuk i kanë braktisur këto ide plotësisht, siç tregon shembulli i samitit Iniciativa e Tre Detrave 2017, që synon bashkëpunim rajonal mes vendeve të detit Adriatik, Baltik dhe detit të Zi.

Krijimi i marrëdhënieve të drejtpërdrejta diplomatike mes Polonisë dhe Kosovës për momentin nuk vjen në konsideratë dhe as që po diskutohet, pavarësisht se Ministria e Punëve të Jashtme e mbështet një hap të tillë. Nën një, elitat e sotme politike ndjekin qasjen e matur të presidentit të ndjerë Kaczynski, dhe nuk ka asnjë shenjë vullneti për të ndry-

shuar status quo-në. Së dyti, brenda elitës së sotme në pushtet, ka ndikim të dukshëm nga një fraksion nacionalist dhe pro-sllav. Dhe së treti, nuk ka zëra që kërkojnë ndryshim të status quo-së, as brenda e as jashtë Polonisë (ndryshe nga viti 2008).

Politika e Polonisë ndaj Kosovës sot është në kuadër të një qasje me të gjërë rajonale. Prioritet ngelet zgjerimi i BE-së. Iniciativat e Varshavës ndaj rajonit janë të kufizuara, me një qasje multilaterale, kryesisht nëpërmjet Grupit të Vishegradit, që është opsioni më i preferuar. Sa i përket marrëdhënieve të drejta, bilaterale, Polonia ka tendencë t'u jap prioritet dy kryeqyteteve - Beogradit dhe Tiranës (me Shqipërinë që është mbështetëse e madhe e agjendës së Kosovës). Në përgjithësi, Polonia e sheh veten si një urë mes shteteve të vjetra dhe të reja anëtare të BE-së dhe është një anëtare aktive e grupit 'miqësor ndaj zgjerimit' brenda BE-së. Polonia dëshiron që ta përdor përvojën e vet të tranzicionit të suksesshëm demokratik nga komunizmi dhe hyrjes në BE, dhe t'i promovoj ato, edhe pse kjo gjë është më prezente ndaj vendeve të Partneritetit Lindor, dhe më pak ndaj Evropës Juglindore. Shkalla dhe niveli i përfshirjes ndryshon, nga projektet e vogla, siç është Akademia e Zgjerimit, një program trajnues për shërbyes civil, e deri te ngjarjet e mëdha shumëpalëshe siç është Samiti i Ministrave të Jashtëm nga V4 dhe Ballkani Përendimor që u mbajt në Varshavë në nëntor 2016. Sa i përket angazhimit të shoqërisë



civile, ka bashkëpunim por me mbështetje të kufizuar nga shteti. Njohja pa prezencë diplomatike krijon një lëmsh ligjor mbi përdorimin e fondeve publike. Prandaj, mbështetja varet kryesisht nga fondet evropiane siç janë Erasmus Plus për OJQ-të, Erasmus Mundus Action 2 për akademikët, apo fokusohet drejt ndihmës humanitare.

Pavarësisht qasjes së deritanishme, interesi i Polonisë ndaj Kosovës vetëm sa do të rritet. Janë tre faktorë kryesorë të identifikueshëm që do të shtyejnë drejt kësaj. Së pari, Polonia është tejet e shqetësuar ndaj ndikimit keqdashës të faktorëve të jashtëm - sidomos Rusisë - në Evropën Juglindore. Kjo shihet si një kërcënim ndaj 'stabilitetit të brishtë' të të gjithë rajonit. Diplomatët polakë vënë në pah ndikimin Rus në Serbi; tentimin për grushtshtet në Mal të Zi; dhe retorikën seperatiste të Milorad Dodik-ut në Republikën Serbe, që ka të bëjë me vizitën e tij në Moskë. Polonia po i kushton vëmendje më të madhe prezencës së Rusisë në Evropën Juglindore për shkak të ngjarjeve në Ukrainë pas Euromaidanit. Polonia është një nga përkrahësit kryesorë të idesë për krijimin e Njësisë për Komunikim Strategjik në Evropën Juglindore, e cila do të pasqyroj punën e Njësisë ekzistuese Lindore StratCom që fokusohet në Partneritetin e vendeve Lindore. Edhe pse Polonia e ka prioritet kërcënimin nga Rusia, ajo i ka parasysh edhe veprimet e aktorëve të tjerë të jashtëm në rajon - Kina, Turqia, vendet e Golfit, dhe faktorëve jo-shtetëror (sidomos

grupet ekstremiste). Faktori i dytë është fakti se shqetësimi për sigurinë në Evropën Juglindore është shtuar pas 2015-tës, kryesisht për shkak të krizës së emigrantëve. Polonia ka bërë apel për bashkëpunim me Evropën Juglindore për të adresuar sfidat nga terrorizmi, xhiahadi, lufta hibride, trafikimi i njerëzve, radikalizimi, ardhja e luftëtarëve të huaj, financimi i terrorizmit si dhe krimi i organizuar. E treta, dhe më e rëndësishmja, Polonia ka vendosur të bëhet anëtare jo-permanente e Këshillit të Sigurimit të OKB-së (2018-19). Përderisa situata në Ukrainë padyshim se do të vazhdoj të jetë prioritet për Varshavën, edhe Kosovën mund ta ketë në konsideratë. Siç është thënë edhe më lartë, edhe pse për Poloninë Kosova nuk është partneri rajonal më i rëndësishëm në Evropën Juglindore, Kombet e Bashkuara mund të bëhen një platformë e re bashkëpunimi, që shkon përtej agjendës për zgjerim të BE-së.

Në nëntë vitet e fundit, Varshava e ka parë Kosovën si një nga aspektet e raportit që ka Polonia me BE-në dhe me SHBA-të. Mirëpo, ndryshimet në politikën e jashtme (pas vitit 2015), bashkë me perceptimin e rrezikut nga Rusia, e kanë shtyrë Poloninë ta rivlerësoj politikën e saj në rajon. Anëtarësimi i Polonisë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, ofron një mundësi për forcimin e marrëdhënieve bilaterale mes Varshavës dhe Prishtinës, edhe pse me paralajmërimin se krijimi i marrëdhënieve të drejtpërdrejta diplomatike ka shumë pak gjasë të ndodhë.

05

GREQIA

IOANNIS ARMAKOLAS

Nga vendet që nuk e kanë njohur Kosovën, Greqia është vendi që ka interesin më të madh politik dhe ekonomik në Ballkanin Perëndimor, që luan një rol kyç sa i përket politikës së zgjerimit të BE-së në rajon, dhe vend që ka marrëdhënie të ngushta, por shpesh të tendosura, me Shqipërinë. Greqia është po ashtu një vend që vazhdon të mos e njoh Kosovën, por që me politikën e saj të anagazhimit me Prishtinën, herë pas here jep fije shprese.

Historia e sjelljes së Greqisë ndaj statusit të Kosovës ka të bëjë me historinë e politikës

greke në Ballkan. Në fillim të viteve 1990-të, e përfshirë në një valë nacionalizimi për shkak të çështjes së Maqedonisë dhe luftërave në Jugosllavi, Greqia u gjend në një pozicion armiqësor me gjithë vendet fqinje dhe në një pozitë miqësore vetëm me Serbinë e Millosheviqit. Kjo, bashkë me rritjen e sentimentit anti-perëndimor, e vuri Greqinë në kundërshtim me të gjithë partnerët perëndimor. Pas gjysmës së dytë të viteve 1990-të, Athina ndryshoi këtë qasje dhe provoi të rregullonte marrëdhëniet me vendet fqinje. Gjatë luftës në Kosovë, në të cilën Greqia nuk mori pjesë, ajo ofroi ndihmë të domos-



doshme për operacionet e NATO-s, dhe mori pjesë në Operacionin e Portit të Aleatëve që menaxhonte fluksin e refugjatëve. Qeveria e Simitis gjeti një rrugë të mesme, përkundër sentimentit të fortë të shumicës dërrmuese të opinionit publik që ishte kundër intervenimit (97 përqind), të opozitës dhe mediave, por dhe të obligimeve ndaj aleatëve të saj në NATO dhe stabilitetit në rajon.

Pas luftës në Kosovë, Greqia iu përkushtua plotësisht vizionit për integrimin e Ballkanit në BE dhe NATO. Aspiratat e vendeve të Ballkanit për t'u pranuar në BE, hovin më të madh e morën gjatë Samitit të Selanikut, në vitin 2003, kur Greqia ishte kryesuese e Presidencës së Këshillit Evropian. Greqia gjithashtu ndihmoi Bullgarinë dhe Rumaninë për të hyrë në BE. Por, mosarritja i zgjidhjes së çështjes së emrit, dhe së fundmi, lëvizjet e qeverisë së Gruevskit në Shkup, u panë nga Athina si provokim dhe e detyruan Greqinë të bllokoj hyrjen e ish Republikës jugosllave të Maqedonisë në NATO dhe nisjen e negociatave për pranim në BE.

Pas shpalljes së pavarësisë, Greqia vendosi të mos e njilte Kosovën, dhe e arsyetoi vendimin e saj duke iu referuar respektimit të së drejtës ndërkombëtare, integritetit territorial të shteteve dhe stabilitetit rajonal. Politikbërësit grek shqetësohshin edhe se Kosova përbënte precedent për Qipron, edhe pse kjo nuk u tha ndonjëherë në formë eksplicite. Në vend të kësaj, Athina deklaroi

se do ta mbështes çdo lloj statusi të Kosovës që do të arrihet në sajë të një marrëveshje të dyanshme mes Beogradit dhe Prishtinës. E rëndësishme është se zyrtarët grekë nuk e përjashtojnë mundësinë e njohjes së Kosovës. Greqia gjithashtu synon promovimin e integritetit të të gjithë Ballkanit, përfshirë Kosovën, në institucionet Euro-Atlantike. Mund të supozohet me të drejtë se kjo gjë nuk mund të ndodhë pa njohjen formale të Kosovës nga Greqia, gjë që bie në kundërshtim me tezën për gjetjen e një zgjidhje të dyanshme. Kjo pozitë ambivalente dhe e lëkundur mund të prodhoj në të ardhmen një çarje brenda qëllimeve të politikës së jashtme greke, sidomos nëse, pavarësisht pritshmërive të BE-së, për t'u pranuar në këtë bllok, Serbia megjithatë nuk do ta njoh shtetësinë e Kosovës

Ka shumë pak debat nga media dhe publiku grek në lidhje me statusin e Kosovës. Me përjashtim të debateve të organizuara nga organizatat think tank të politikave, që ndiqen nga audienca të specializuara, dhe që rrallë herë pasqyrohen në mediat ditore. Gjatë këtyre debateve, akademikë, ish-politikanë dhe ish-diplomatë të ndryshëm, e kanë vënë në pikëpyetje politikën e Greqisë dhe kanë argumentuar në mbrojtje të njohjes së Kosovës. Por këto qëndrime nuk kanë arritur të gjenerojnë interes te publiku i gjërë e as të krijojnë brenda qarqeve politike një momentum për njohje. Çështja e Kosovës, por edhe politika e jashtme në



përgjithësi, nuk janë prioritet për Greqinë e përfshirë nga krizat. Duhet thënë se çështja e Kosovës përdoret shpesh nga politikanë të ekstremit nacionalistë gjatë fjalimeve të tyre anti-shqiptare dhe anti-myslimane.

Pavarësisht se Athina nuk e ka njohur Kosovën, ajo ka ndërmarrë hapa për angazhim me të, duke e pranuar realitetin e ri në terren, dhe ndoshta, edhe për të kompensuar për politikat e njëanshme të viteve 1990-të. Ndryshe nga të gjitha vendet e tjera të BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën, Greqia ka një Zyrë Ndërlidhëse në Prishtinë, e cila udhëhiqet nga një Ambasador. Janë zhvilluar një numër i madh takimesh formale dhe joformale mes zyrtarëve të lartë të Greqisë dhe Kosovës që nga viti 2008. Greqia i pranon dokumentet kosovare të udhëtimit, dhe automjeteve me targa kosovare u lejohet hyrja në Greqi. Athina e ka ndihmuar anëtarësimin e Kosovës në Bankën Botërore, Fondin Ndërkombëtar Monetar, si dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, duke votuar në favor të aplikimit të Prishtinës (në BERZH) ose duke krijuar kuorumin e duhur për votim. Përveç kësaj, Greqia është i vetmi vend i BE-së që nuk e ka njohur Kosovën, e që nuk mori pjesë me deklarata me shkrim apo me gojë gjatë diskutimeve për rastin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Gjithashtu, përgjatë viteve, zyrtarët grekë arritën të kenë nivele të larta pranë në

Kosovë, më shumë se çdo vend tjetër që nuk e ka njohur atë. Ambasadori Dimitris Moskopoulus, gjatë kohës që udhëhiqte Zyrën Ndërlidhëse Greke në Prishtinë, ishte edhe Ndërmjetësues i BE-së për Trashëgiminë Kulturore dhe Fetare Serbe në Kosovë. Në këtë detyrë, ai arriti një nivel bashkëpunimi me institucionet qeveritare të Kosovës, diçka që asnjë diplomat nga vendet që nuk e kanë njohur Kosovën nuk e kishte bërë më parë. Moschopoulos luajti një rol instrumental për t'i sjellë bashkë në tavolinën e negociatave qeverinë e Kosovës dhe Kishën Ortodokse Serbe, dy institucione që nuk kishin bashkëpunuar ndonjëherë formalisht apo joformalisht. Edhe shefja aktuale e Zyrës së Ndërlidhjes, Ambasadorja Konstantina Athanasiadou, është mjaft aktive në Prishtinë, dhe, njëlloj si parardhësi i saj, është prente në media dhe forume publike në Kosovë. Po ashtu, një diplomate e vjetër greke, ambasadorja Alexandra Papadopoulou, është emëruar Shefe e Misionit të EU-LEX-it që nga korriku, 2016.

Vet Zyra Ndërlidhëse ka qenë aktive me organizimin e vizitave të delegacioneve të bizneseve nga Greqia dhe në përgjithësi me promovimin e tregtisë dhe investimeve bilaterale. Lidhja ekonomike mes dy vendeve është forcuar gjatë viteve të fundit, si edhe shkëmbimet akademike dhe ato të shoqërisë civile. Një tjetër element i rëndësishëm i politikës së angazhimit, është edhe marrëveshja fillestare për hapjen e Zyrës



Përfaqësuese të Çështjeve Tregatë dhe Ekonomike të Kosovës në Greqi, e cila u arrit gjatë vizitës së Ministrisë të Jashtëm të Kosovës Enver Hoxhaj në Athinë, në mars 2013. Kjo marrëveshje u kritikua nga opozita nacionaliste në Greqi, dhe progresi i zbatimit ka qenë i avashtë për shkak të luhatjes së prioritetëve të qeverisë së Kosovës.

Politika e Greqisë për angazhim me Kosovën ka vazhduar edhe nën qeverinë SYRIZA-ANEL, edhe pse në të kaluarën të dy këto parti kanë mbajtur qëndrime mjaft armiqësore ndaj Kosovës. Gjatë postit të tij, Ministri i Punëve të Jashtme Nikos Kotzias e vazhdoi punën aty ku e kishte lënë parardhësi i tij, duke forcuar marrëdhëniet bilaterale edhe më tej. Gjatë vizitës së tij në Kosovë në korrik 2015, ai dha sinjalin se Greqia do ta mbështes aplikimin e Kosovës për praninë në Interpol dhe UNESCO. Mirëpo, asnjë nga këto dyja nuk u materializuan, kryesisht për shkak të reagimeve nga opozita greke dhe qeveria serbe. Përderisa politika e angazhimit është kritikuar ashpër nga forcat politike populiste dhe nacionaliste, anëtarët e partive kryesore - siç janë Demokracia e Re, PASOK dhe SYRIZA - gjatë kohës që kanë qenë në opozitë, gjithashtu i kanë kritikuar qeveritë në fjalë për kinse promovimin e tepruar të marrëdhënieve me Kosovën. Edhe Ambasada e Serbisë në Athinë rregullisht proteston kundër kësaj politike, e cila kritikohet edhe nga zyrtarët serb në Beograd.

Në përgjithësi, çështja e Kosovës shpërfaq një çarje në mes të, në njërin anë, realpolitikës së politikave të jashtme të angazhimit me Prishtinën, dhe në anën tjetër, të qëndrimit të njëanshëm që ngjan me qasjen stereotipike të viteve 1990-të, e cila e vë në pikëpyetje ose e kundërshton fuqishëm bashkëpunimin e afërt. Duket se qasja e parë kuptohet më mirë nga diplomatët profesionistë dhe disa politikanë të njohur, dhe kultivohet tërësisht nga qeveria ditore. Pikëpamja e dytë është më shumë emocionale. Ajo përkrahet kryesisht nga parti të vogla, që ushqehen me teori konspirative dhe kultivojnë sentiment anti-Perëndimor; por, është e përhapur edhe në partitë e tjera opozitare që e përdorin për të fituar lehtë pikë politike. Kjo situatë tregon se si për partitë greke, gjetja e një rruge alternative është kthimi tek pikëpamjet politike të formuluar në vitet 1900-të. Në këtë kontekst, më shumë indinjatë shkakton politika e angazhimit me Kosovën që nga shumica si politikë e pavend, se sa mos-njohja e Kosovës.

Përderisa Greqia nuk e ka njohur Kosovën për gati një dekadë, vështirë të imagjinohet një skenar ku Greqia e njeh një vend 'pa pritje e pa kujtuar'. Athina do ta ndjek me inerci rrugën e lehtë të mos-njohjes dhe vijimin e angazhimit të fortë. Fundja, kjo është një strategji e suksesshme, e cila edhe pse 'nuk i bën të gjithë të lumtur', së paku 'nuk e bën askënd të palumtur'. Që Greqia ta konsid-



eroj seriozisht ndryshimin e qëndrimit, do të duhej të ndodhte dicka ‘spektakolare’ apo e ‘jashtëzakonshme’. Dhe për momentin kjo gjë nuk duket se do të ndodhë. Marrëdhëniet bilaterale do të vazhdojnë të ndërtohen ‘me vështirësi’. Prandaj, është jashtëzakonisht e rëndësishme që marrëdhëniet mes Greqisë dhe Kosovës të vazhdojnë të përmirësohen, sidomos nëse Kosova do që ta mbajë gjallë atë fije shprese se njohja mund të ndodhë. Angazhimi duhet të intensifikohet edhe më tej, edhe me iniciativën dhe insistimin e kosovarëve nëse është e nevojshme. Mirëpo, vlen të theksohet se insistimi i Kosovës për reciprocitet të plotë dhe për trajtim të njëjtë si shtetet që Greqia i ka njohur, mund të jetë kundër-produktiv. Edhe pse ky insistim mund t’i jap kënaqësi vetbesimit të Kosovës, në anën tjetër mund ta dobësoj politikën greke të angazhimit, sepse krijon përshtypjen se kosovarët janë lakmitarë dhe mosmirënjohës.

Gjithashtu, tendenca e viteve të fundit për politikë të koordinuar mes Kosovës dhe Shqipërisë shihet me skepticizëm në Athinë. Në përgjithësi, Greqia ndjehet jorehat kur vendet e banuara me shqiptarë koordinohen dhe veprojnë si një. Përderisa askush nuk mund ta ndaloj apo kundërshtoj bashkëpunimin intensiv në çështje të kulturës dhe çështje politike të një rëndësie të ultë, sinjalet se politika e lartë po ndjek të njëjtën rrugë, perceptohet nga Greqia si një zhvillim i rrezikshëm që duhet ndaluar apo

vonuar. Kjo vetëm sa i forcon zërat që janë kundër njohjes. Gjithashtu, kampi kundër njohjeve do të fitoj më shumë mbështetje në Greqi, nëse duket sikur zyrtarët dhe opinionistët në Kosovë po e mbështesin Shqipërinë në çështjet që janë shumë sensitive për Greqinë. Ekzistojnë disa mospajtime të rëndësishme bilaterale mes Athinës dhe Tiranës, që e bën marrëdhënien e tyre tejet të komplikuar; edhe pse, në të njëjtën kohë ato ndajnë shumë gjëra, nuk e lejojnë marrëdhënien e tyre bilaterale të përkeqësohet. Kosova vetëm sa do të humbas nëse e mbështet pa kusht, për shembull, agjendën e aktivistëve çamë kundër Greqisë apo nëse e përvetëson diskursin e viktimizimit të të gjithë kombit shqiptar nga fqinjët e tyre.

Si përfundim, thirrjet e viteve të fundit për bashkimin e Shqipërisë me Kosovën vetëm sa do ta vështirësojnë situatën për Prishtinën. Këto thirrje i forcojnë zërat në Greqi që kundërshtojnë absolutisht çdo lloj perspektive të njohjes dhe do ta ngurtësojë edhe më tej vendosmërinë e tyre. Këto thirrje pengojnë edhe përpjekjen e atyre që janë - me apo pa ngurrim - të gatshëm ta mendojnë një ndryshim të politikës. Pse duhet dikush ta njoh pavarësinë e një vendi, nëse ai vend është i gatshëm ta braktisë pavarësinë e vet për t’u bashkuar me një shtet tjetër?

06 SLLOVAKIA

MILAN NIČ

Në Kosovë ekziston një keqkuptim mbi faktin nëse Sllovakia është shtyrë drejt mos-njohjes për shkak të çështjeve të brendshme dhe trashëgimisë historike, apo gjeopolitikës. Në kohën kur Kosova shpalli pavarësinë, Sllovakia ishte bërë tashmë vend anëtar në BE dhe NATO, dhe ishte pozicionuar në shumë çështje në anën e aleatëve të saj kryesor. Duke e përdorur faktin se njohja e shteteve është e drejtë kombëtare, dhe se ka edhe të tjera vende në BE dhe NATO që ndajnë të njëjtin shqetësim, Bratisllava vendosi në vitin 2007-2008 të marrë këtë qëndrim ndaj Kosovës, përkundër

konsensusit përëndimor. Ajo mban këtë qëndrim deri sot, por, duke u bërë gradualisht gjithnjë e më pragmatike në politikën e saj evropiane në raport me Prishtinën.

Sllovakia është bërë vend i pavarur në fillim të viteve 1990-të, pas ndarjes me Republikën Çeke. Ndarja nga Çekosllovakia ishte rezultat i një marrëveshje politike mes dy liderëve të zgjedhur në Pragë dhe Bratisllavë në vitin 1992. Për shkak se nuk kishte mospajtime territoriale, çështje etnike apo konflikte historike mes dy vendeve, ndarja ishte e mundur në bazë të kushtetutës. Siç pati thënë Ministri



i Jashtëm çek në atë kohë Karel Schwarzenberg, ky rast ishte shembull se “divorci i lumtur” është i mundur. Në disa libra të historisë, ndarja e lehtë dhe e rregullt e federatës Çekosllovaqe shihet rast komplet i kundërt në krahasim me ndarjen e dhunshme dhe kaotike të Jugosllavisë, e cila përfundoi duke pasur disa lufta të tmerrshme (me Serbinë si vendi dominant në pushtetin federal) që zgjatën gati një dekadë. Një nga tiparet që karakterizojnë këndvështrimin sllovak, është hezitimi për ta pranuar faktin se nuk ka pasur asnjë hapësirë për arritjen e një marrëveshje politike mes Serbisë dhe Kosovës pas luftës së 1999-tës, dhe zgjidhja e problemit duhej të imponohej nga jashtë.

Një tjetër arsye që e determinoi pikëpamjen sllovaqe, ishte një lloj ndjeshmërie e thellë historike ndaj çështjes së kufinjve dhe shkëputjes së minoriteteve etnike. Kjo gjë ka filluar qysh në ndarjen e Mbretërisë Austro-Hungareze gjatë viteve 1918-1920, kur Sllovakia për herë të parë doli në hartë si territor që përfshinte edhe rajone të banuara me hungarezë etnik në jug të vendit. Gjatë luftës së dytë botërore, Gjermania naziste e Hitlerit, e shpërbleu Hungarinë duke ja kthyer këto toka, por kjo u anulua pas vendosjes së paqes të vitit 1945. Edhe pse katër dekada komunizëm i stabilizuan kufinj të mes jugut të Sllovakisë përgjatë lumit Danub, shqetësimet e vjetra u kthyen gjatë viteve 1990-të, kur partitë politike në Budapest filluan të kërkonin ribashkimin e hungarezëve në gjithë Pellgun e

Karpatave, përtej kufijve. Kjo pasiguri e thellë rreth kufijve dhe pakicave etnike ishte një nga faktorët kryesor që përcaktuan diplomacinë sllovaqe dhe interesimin e saj të veçantë ndaj zhvillimeve në Ballkanin Perëndimor në vitet 1990. Shumë zyrtarë sllovakë kanë luajtur rol të rëndësishëm në çështjet e rajonit gjatë njëzet viteve të fundit. Veçanërisht, Miroslav Lajčák, diplomati sllovak i cili pas postit të tij si ministër i punëve të jashtme, shërbeu si i dërguar i posaçëm i BE-së për mbikqyrjen e referendumit të pavarësisë së Malit të Zi në vitin 2006, dhe si Përfaqësues i Lartë i BE-së në Bosnje dhe Herzegovinë (2007-2009). Faktori i tretë që përcaktoi qasjen e Sllovakisë ndaj Kosovës, ishte miqësia historike me Serbinë që ka filluar qysh në shekullin e 19-të. Përveç solidaritetit të përgjithshëm mes sllavëve, miqësia u krijua edhe për shkak të minoritetit të vogël, por të rëndësishëm, sllovak, në krahinën veriore serbe të Vojvodinës.

Pothuajse që nga fillimi, Kosova ka qenë një çështje mbi të cilën është debatuar në politikën sllovaqe. Fushata e NATO-s kundër Serbisë në vitin 1999 u kundërshtua fuqishëm në vend. Por, qeveria sllovaqe e asaj kohe, nën kryeministrin e qendrës së djathtë, Mikuláš Dzurinda, vendosi megjithatë të mbështes sulmet ushtarake dhe ofroi të drejtën e përdorimit të hapësirës ajrore të vendit nga NATO, pasi vendi ishte në pritje të miratimit përfundimtar të anëtarësimit në NATO. Pas përfundimit të konfliktit, Sllovakia vendosi të kontribuoi me trupat e saj në misionin



e NATO-s të krijuar për të ruajtur paqen në Kosovë (KFOR). Ky kontribut arriti maksimumin e 140 trupave, të cilët u tërhoqën përfundimisht në vitin 2010. Ajo gjithashtu kontribuoi me personel në misionin e OKB-së në Kosovë, i cili u krijua për të mbikëqyrur zhvillimin politik në Kosovë dhe për ta përgatitur atë për procesin përfundimtar të statusit. (Në vitin 2006, 42 anëtarë të ushtrisë dhe civil sllovakë humbën jetën në aksidentin ajror të Hanit mbi Hungari, duke u kthyer nga Kosova). E rëndësishme është se në mesin e viteve 2000, Ministria e Jashtme e Sllovakisë hapi një zyrë ndërlidhëse në Prishtinë, e cila vazhdon të jetë aty edhe sot.

Në janar 2006, OKB-ja filloi procesin për përcaktimin e statusit përfundimtar të Kosovës. Kur u pa qartë se bisedimet mes institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës dhe qeverisë serbe, nuk do arrinin të gjenin një zgjidhje të përbashkët, atëherë filloi përgatitja për shpalljen unilaterale të Pavarësisë. Qasja fillestare pozitive e diplomacisë sllovaqe ndaj aspiratave të Kosovës u pengua nga politika e brendshme. Mosmarrëveshjet e nxehta në parlamentin sllovak mbi të ashtuquajturin plan i Ahtisaarit, përfunduan me një rezolutë bipartizane në vitin 2007. Përmbytja e rezolutës nuk kishte status të detyrueshëm, por u aprovua nga shumica dërrmuese e partive politike të Sllovakisë (me përjashtim të partisë etnike hungareze), dhe e përcaktoi mos-njohjen nga Sllovakia një vit më vonë. Kur, në shkurt të vitit 2008, Koso-

va shpalli pavarësinë, qeveria sllovaqe, sipas rregullave të rezolutës parlamentare, deklaroi se nuk do ta njohë Kosovën shtet të pavarur dhe sovran, dhe insistoi papushim se zgjidhja përfundimtare duhej të ishte e pranueshme nga të dyja palët, autoritetet në Beograd dhe ato në Prishtinë. Po atë vit, Bratisllava votoi edhe në favor të rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së të hartuar nga Serbia, që e çoi çështjen e Shpalljes së Pavarësisë së njëanshme në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND). Kur çështja doli para GJND-së, Sllovakia paraqiti një deklaratë me shkrim. Pas mendimit të Gjykatës, të dhënë në korrik 2010, Bratisllava e bëri të qartë se nuk do ta ndryshonte qëndrimin e saj ndaj njohjes.

Edhe pse Sllovakia nuk e ka njohur Kosovën, ajo është një nga tre vendet që nuk e ka njohur por ka pasur vullnetin për t'u angazhuar me Prishtinën. Edhe pas shpalljes së pavarësisë, Sllovakia e ka mbajtur zyrën ndërlidhëse në Prishtinë. Gjithashtu, kontaktet mes zyrtarëve sllovakë dhe zyrtarëve të lartë kosovarë kanë qenë të rregullta, edhe pse këto ngjarje janë mbajtur larg vëmendjes së publikut, dhe janë pasqyruar shumë pak në media. Këto përpjekje janë udhëhequr nga ish-ministri i punëve të jashtme, Miroslav Lajcak. Procesi i angazhimit u bë më i lehtë për shkak të procesit të normalizimit mes Beogradit dhe Prishtinës, të udhëhequr nga BE-ja. Në momentin që Serbia u bë më e hapur ndaj angazhimit me Kosovën, edhe Sllovakia gradualisht filloi ta shtynte përpara qëndrim-



in ndaj Kosovës. Për shembull, në korrik të vitit 2012, pa bërë zhurmë e pa ndonjë paralajmërim, qeveria sllovaqe deklaroi se do t'i njoh pasaportat e Kosovës. Më vonë, po atë vit, ministri i jashtëm i Kosovës, Enver Hoxhaj e vizitoi Bratisllavën për të folur në një ngjarje të një think tank-u të njohur dhe zhvilloi një takim jozyrtar me Lajçakun. Në vitin që pasoi, një grup prej nëntë anëtarëve të parlamentit sllovak, nga parti të ndryshme, e vizituan Kosovën.

Deri në vitin 2013, Sllovakia dukej aq e angazhuar me Prishtinën, sa disa vëzhgues nga jashtë menduan se ajo po përgatitej ta njihje Kosovën. U spekulua se kjo gjë do të ndodhte nëpërmjet një iniciative të përbashkët me Greqinë ose Rumaninë, ose të dyja bashkë. Bindja se njohja do të ndodhte u rrit edhe nga zgjedhjet presidenciale në mars 2014. Kandidati kryesor i pavarur, Andrej Kiska, deklaroi publikisht se Sllovakia duhet ta njoh Kosovën - qëndrim ky që u sulmua vazhdimisht nga rivali i tij kryesor, kryeministri Robert Fico, si deklaratë 'e papërgjegjshme'. Fico i humbi këto zgjedhje, por vazhdoi të ishte në krye të qeverisë dhe lider i partisë në pushtet. Mirëpo, ky episod i një profili kaq të lartë politik, pati efektin e kundërt: ministrit të jashtëm Lajçak iu bë me dije se qasja e tij fleksibile ndaj Kosovës, nuk ishte në të njëjtën linjë me atë të kryeministrit, ndërsa presidenti i posazgjedhur Kiska, hoqi dorë nga konfrontimi me qeverinë e Ficos, mbi një çështje aq të ndjeshme të politikës së jashtme, që për më

tepër ishte jashtë kompetencave të tij (njohja e shteteve).

Në të njëjtën kohë, kjo ngecje në Bratislavë u përforcua edhe nga ngjarjet e mëdha që ndodhën jashtë vendit. Pushtimi i Rusisë dhe më vonë, aneksimi i Krimesë, që ndodhën po ashtu në mars 2014, e vuri përsëri çështjen e ndarjeve dhe të integritetit territorial në krye të diskutimeve të politikës së jashtme në Evropë dhe më gjerë. Në Sllovakia, kjo ngjarje ishte një tjetër dëshmi që tregonte se komuniteti ndërkombëtar duhet të respektoj të drejtën ndërkombëtare dhe integritetin territorial të Ukrainës. Kështu, u arrit një konsensus i fortë ndërpartiak për të mos folur më për njohjen e Kosovës, dhe kjo gjë, nga këndvështrimi sllovak, ishte në përputhje me qëndrimin kundër ndarjes së paligjshme të Krimesë. Sipas kushtetutës sllovaqe, njohja e shteteve është kompetencë e ekzekutivit. Megjithatë, çdo qeveri sllovaqe që dëshiron ta njohë Kosovën, së pari duhet që formalisht të iniciojë një rezolutë të re në parlament, e cila më pas duhet të aprovet me shumicë votash. Asnjë nga katër qeveritë e njëpasnjëshme që nga viti 2007, nuk kanë pasur guxim, interes apo arsye për ta marrë këtë rrezik. Megjithatë, disa zëra të shquar politik janë të mendimit se Sllovakia duhet ta pranojë shtetësinë e Kosovës. Për shembull, Kryetari i Komitetit për Marrëdhënje me Jashtë në Parlamentin Sllovak, František Šebej, që përfaqëson një parti civile sllovaiko-hungareze, ka thënë se Bratislava duhet



ta pranojë realitetin e pavarësisë së Kosovës. Gjithashtu, në vitin 2015 u mbajt një seancë parlamentare mbi këtë çështje, e organizuar nga një think tank vendor.

Edhe pse Sllovakia nuk e ka njohur Kosovën, dhjetëvjeçari i fundit ka dëshmuar se Bratisllava e ka vullnetin për angazhim. Sllovakia është zyrtarisht e pranishme në Prishtinë dhe mes zyrtarëve të të dyja vendeve ka pasur kontakte të shpeshta politike. Kjo ka hapur hapësira të reja angazhimi mes dy vendeve. Një mundësi e propozuar është hapja e një zyre ndërlidhëse tregare të Kosovës në Bratisllavë. Gjatë viteve 2013-2014, diplomatët sllovakë dhe ata kosovarë, kanë diskutuar në mënyrë diskrete modalitetet e duhura ligjore dhe teknike për një hap të tillë, por kjo iniciativë për momentin ka stagnuar. Bratisllava i ka dhënë shenjë Prishtinës që është e gatshme ta çojë përpara këtë hap, në rast se një zyrë e ngjashme hapet në Greqi, diçka që deri tani nuk është materializuar. Kjo mundësi e mirë, mbase nuk kthehet më. Kjo është e rëndësishme, sepse në këtë mënyrë Kosova do të ketë mundësinë të jetë e pranishme në kryeqytetin sllovak dhe, rrjedhimisht, të komunikoj drejtpërdrejtë me politikanët dhe popullin sllovak. Ndërkohë, duket sikur sensi i pragmatizmit vazhdon. Sllovakia e ka mbështetur nënshkrimin e Marrëveshjes për Stabilizim Asociim mes BE-së dhe Kosovës. Mirëpo, qeveria sllovaqe ka pasur kujdes edhe që të mos armiqësohet me Serbinë. Kështu, në nëntor 2015, Sllovakia votoi kundër pranimit

të Kosovës në UNESCO, edhe pse vendet si Rumania dhe Greqia thjesht abstenuan. Lajcak më vonë deklaroi së vepruan kështu që të mos rrezikohej procesi i dialogut Beograd-Prishtinë. Gjithashtu, Sllovakia ka marrëdhënje shumë më të mira tregtare me Serbinë.

Përderisa qëllimi kryesor dhe i fundit i Kosovës është padyshim njohja, për momentin, ky nuk duhet të jetë fokusi kryesor. Ministria e Jashtme e Kosovës duhet të ketë një plan të qartë, me rezultate të prekshme. Gjatë vitit të fundit, duket sikur ka pasur shumë pak iniciativë dhe momenti i duhur ka ikur. Është gjithashtu e rëndësishme që shoqëria civile të luajë një rol të rëndësishëm. Për shembull, Ministri i Kosovës për Integritet Evropian dhe një delegacion i aktivistëve të shoqërisë civile të Kosovës, me mbështetjen e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), e vizituan Bratisllavën në shtator 2016. Megjithatë, si përfundim, për shkak të ndryshimeve të mëdha në BE dhe në marrëdhënjet transatlantike, është e rëndësishme të kuptohet se presioni për njohje nga SHBA-ja, Gjermania dhe Britania e Madhe në bisedime dypalëshe është zbehur ose ka stagnuar. Ashtu siç qëndrojnë gjërat sot, ka shumë pak shenja që tregojnë se qëndrimi ndaj njohjes do të ndryshoj në një të ardhme të afërt. Në ndërkohë, shumë punë mund të bëhet për të përmirësuar raportet dhe për të përgatitur terrenin për njohje, kurdo që një mundësi e tillë të bëhet reale.

07 RUMANIA

PAUL IVAN

Si vend anëtar i Bashkimit Evropian që në veri, lindje dhe jug-perëndim kufizohet me vende që nuk janë në BE, Rumania ka interes për integrimin Evropian dhe Euro-Atlantik të Ballkanit Perëndimor, proces ky që do ta forconte edhe sigurinë e saj. Me vite të tëra, Bukureshti ka investuar për stabilitetin në rajon. Rumania ka marrë pjesë në pothuajse të gjitha misionet paqeruajtëse dhe të vendosjes së paqes në Bosnje e Hercegovinë, Shqipëri, Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, si dhe Kosovë.

Rumania tradicionalisht ka pasur raporte të mira me Serbinë fqinje. Rumunët janë të prirur të kenë mendim pozitiv për Serbinë për shkak të lidhjeve të mira mes dy kombeve, së paku në krahasim me raportin që Rumania ka me vendet e tjera fqinje. Megjithatë, marrëdhëniet mes këtyre dy vendeve nuk është që s'kanë vështirësi. Më 28 shkurt 2012, Rumania e shtyu për disa orë marrëveshjen për t'i dhënë Serbisë statusin e vendit kandidat për BE në Këshillin për çështje të përgjithshme të BE-së, sepse kërkonte nga Beogradi që të bëj më shumë për përmisimin dhe mbrojtjen e të drejtave



të minoritetit rumun/vllah në Serbi. Edhe afërsia e Beogradit me Moskën ngryset vetulla në Bukuresht.

Para fillimit të luftës (1998-1999), Kosova është përmendur fare pak në debatet e brendshme në Rumani. Në tetor të vitit 1998, Rumania i dha të drejtë ajrore të kufizuar flotës ajrore të NATO-s për situata emergjence apo të paparishikuara - edhe pse kjo u kundërshtua nga Partia Social-Demokrate opozitare, partia më e madhe në vend në atë kohë, si dhe nga partia nacionaliste, Partia e Rumanisë së Madhe, dhe këto dy parti e kritikuan intervenimin perëndimor në Kosovë. Më 30 mars 1999, parlamenti hartoi një deklaratë ku kërkonte një zgjidhje të konfliktit që do të garantonte fundin e dhunës ndaj popullatës civile, dhe veçanërisht kundër qytetarëve të minoritetit shqiptar në Kosovë; respektim të të drejtave të qytetarëve që i përkasin një minoriteti brenda hapësirës Jugosllave; kthimin e popullatës së zhvendosur; dhe integritetin territorial dhe sovranitetin e Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë. Në prill 1999, qeveria rumune aprovoi përdorimin e pakufizuar të hapësirës së saj ajrore për operacionet e NATO-s kundër Serbisë, por në të njëjtën kohë vazhdoi të mbështes integritetin territorial të Serbisë.

Qeveria rumune nuk pranoi ta njihte shpalljen e pavarësisë së Kosovës në shkurt 2008.

Në fakt, e gjithë klasa politike në Rumani e kundërshtoi atë, përveç Unionit Demokratik të Hungarezve në Rumani (UDHR), që është edhe organizata kryesore politike që përfaqëson hungarezët etnik të Rumanisë, të cilët kërkojnë autonomi territorial të Székely Land, një rajon etnografik që ndodhet në Transilvaninë Lindore. Parlamenti hartoi një deklaratë ku thuhej se “nuk janë përmbushur kushtet për ta njohur një entitet të ri”, dhe se “vendimi në Prishtinë dhe njohja potenciale e shpalljes unilaterale të pavarësisë nga shtetet e tjera, nuk mund të interpretohet si precedent për rajonet e tjera”. Duke refuzuar njohjen e të drejtave kolektive të minoriteteve etnike, autoritetet në Rumani thanë se shpallja unilaterale e pavarësisë nga Kosova, është në kundërshtim me ligjin ndërkombëtar dhe se ka krijuar një precedent të rrezikshëm që mund të përdoret nga lëvizjet e tjera separatiste, siç është grupi separatist pro-rus në Transnistria.

Edhe pse refuzimi fillestar i njohjes së pavarësisë së Kosovës duket se është bazuar kryesisht në arsye ligjore, dhe shihet në Rumani si pozitë parimore, ka pasur edhe faktorë të tjerë që kanë luajtur rol, si për shembull kundërshtimi i lëvizjeve separatiste. Rol ka luajtur edhe dëshira për të mos i dhënë liderëve të hungarezëve rumun argumente shtesë që mund t'i përdorin në favor të autonomisë rajonale. Presidenti rumun refuzoi krahasimet mes shqiptarëve të



Kosovës dhe minoritetit hungarez në Rumani, duke thënë se, ndryshe nga Kosova, ky minoritet gëzon të drejta politika, kulturore dhe arsimore në Rumani. Marrëdhëniet e mira historike me Serbinë fqinje gjithashtu luajtën rol. Përderisa nuk ka asnjë bazë reale armiqësie mes Rumanisë dhe Kosovës, ekspertë të shumtë rumunë e kanë kritikuar procesin se si Kosova e shpalli pavarësinë, dhe besojnë se rajoni nuk ka dhënë dëshmi se mund të jetë ekonomikisht i vetqëndrueshëm. Përveç kësaj, presioni diplomatik nga partnerët evropianë, siç është Mbretëria e Bashkuar, për ta njohur Kosovën, ose për ta lejuar Kosovën të pranohet në organizata rajonale, nuk është pritur mirë.

Pas përmirësimit të marrëdhënieve mes Beogradit dhe Prishtinës, presidenti rumun dhe qeveria, e zbutën kundërshtimin e tyre ndaj angazhimit me Kosovën. Edhe pse në maj 2011, presidenti rumun e kishte anuluar pjesëmarrjen e tij në takimin e Varshavës me kryetarët e shteteve dhe qeverive të Evropës Lindore dhe Qendrore me Presidentin e SHBA-ve Barak Obama, për shkak të prezencës së presidentit të Kosovës në atë takim, në vitet që pasuan, Rumania organizoi disa takime shumëpalëshe ku Kosova merrte pjesë, përfshirë edhe takime të niveleve të larta. Kosova u bë pjesë e Procesit të Bashkëpunimit Juglindor gjatë samitit të mbajtur në Bukuresht në qershor 2014, kur Rumania ishte kryesuese e zyrës, zhvillim ky që u mundësua nga karakteri

jo-institucional i këtij formati rajonal të bashkëpunimit, me pajtimin e Serbisë, dhe me emrin e Kosovës në fusnotë. Gjithashtu, gjatë aplikimit të pasuksesshëm të Kosovës në UNESCO në vitin 2015, Rumania abstenoj nga votimi, bashkë Greqinë, një vend tjetër i BE-së që nuk e ka njohur, si dhe Poloninë e cila e ka njohur Kosovën. (Tre vendet e tjera të BE-së që nuk e kanë njohur, Qipro, Spanja dhe Sllovakia, votuan kundër aplikimit.) Rumania, bashkë me vendet e tjera që nuk e kanë njohur Kosovën, nuk e kundërshtuan nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit mes BE-së dhe Kosovës në tetor 2015. Për Rumaninë, kjo marrëveshje nuk bie ndesh me qëndrimin e saj ndaj pavarësisë së Kosovës dhe nuk përbën njohje.

Në një moment, u duk sikur një konflikt mes ish-Presidentit Basescu dhe Kryeministrit Ponta do të mund ndryshonte shanset që Rumania ta njihje pavarësinë e Kosovës. Përderisa presidenti e kundërshtonte njohjen e pavarësisë, edhe pse jo aq fuqishëm sa në vitin 2008, kryeministri dha disa disa deklaratë në favor të njohjes së Kosovës gjatë vitit 2013, që krijuan përshtypjen se kjo gjë do të ndodhte në fund të mandatit të dytë dhe të fundit të Basescut, në dhjetor 2014. Mirëpo, ky qëndrim i kryeministrit nuk vinte nga ndonjë rishqyrtim i mirëfilltë i pozitës së Rumanisë, por u duk se kishte të bënte më shumë me dëshirën e tij për të marrë pikë duke kundërshtuar presidentin dhe për të përmirësuar



imazhin e tij karshi aleatëve perëndimor të Rumanisë. Rumania kishte pak gjasa që do ndryshonte qëndrimin e saj pa pasur ndonjë arsye të fortë; edhe në rast se Ponta do t'i fitonte zgjedhjet parlamentare në nëntor 2014, të cilat ai i humbi. Presidenti aktual rumun, Klaus Iohannis, e ka mbajtur po të njejtin qëndrim si paraardhësit e tij dhe nuk ka asnjë indikator që kjo gjë do të ndryshoj në të ardhmen.

Pavarësisht politikës së saj të vazhdueshme për të mos e njohur Kosovën, Rumania ka qenë pragmatike dhe ka punuar me vendet e tjera anëtare të BE-së sa i përket çështjeve praktike që kanë të bëjnë me zhvillimin e Kosovës dhe integrimin në BE. Rumania ka qenë një nga kontribueset kryesore të misioneve ndërkombëtare në Kosovë, siç janë UNMIK, EULEX dhe KFOR, dhe Bukureshti e ka mbajtur kontingjentin e saj të xhandarmërisë në Kosovë edhe pas shpalljes së pavarësisë. Në shtator 2011, irritimi që shkaktoi refuzimi i disa prej vendeve të mëdha të BE-së për ta pranuar Rumaninë në zonën Shengen, e detyroi Bukureshtin t'i tërhiqte policët dhe xhandarmarinë e saj nga EULEX-i. Megjithatë, gjatë vitit 2016-2017 ajo ka vazhduar të marrë pjesë në misionin e NATO-s në KFOR, me rreth 50-60 shërbyes rumun. Rumania gjithashtu i lejon banorët e Kosovës të udhëtojnë në Rumania, jep viza, dhe mban shënime të veçanta mbi tregtinë me Kosovën. Rumania ka një Zyrë Ndërlidhëse në kuadër të misionit të

OKB-së. Ka edhe shkëmbim njerëzish dhe vizitash, edhe pse nuk ka marrëdhënie diplomatike. Për shembull, në prill 2015, Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur dhe Këshilli Britanik në Kosovë organizuan vizitën e një delegacioni me gazetarë dhe analistë nga Rumania dhe që nga viti 2008 janë zhvilluar disa ndeshje sportive mes ekipeve kosovare dhe rumune.

Në të ardhmen, nuk duket se mund të ketë ndonjë arsye që do ta bënin Rumaninë të ndryshoj qëndrimin e saj ndaj njohjes. Rritja e lëvizjeve separatiste në zonën e Detit të Zi, përfshirë Abkazinë dhe Osetinë e Jugut, okupimi i Krimesë nga Rusia, si dhe lufta në Ukrainën Lindore, vetëm sa e kanë komplikuar situatën edhe më shumë dhe i kanë dhënë Bukureshtit arsye të tjera për të qenë e matur. Këto ngjarje e kanë ulur edhe presionin ndaj Rumanisë për ta njohur pavarësinë e Kosovës. Gjithashtu, një shtysë e re e minoritetit hungarez për më shumë autonomi për Székely Land, dhe presioni publik nga Hungaria në këtë aspekt, po e bën Rumaninë që të mos ndryshoj qëndrim. Së fundmi, referendumi në Kataloni dhe Kurdistanin në Irak i kanë dhënë Bukureshtit edhe më shumë arsye për të pasur kujdes. Bukureshti e ka mbështetur fuqishëm sovranitetin dhe integritetin territorial të Spanjës, duke kundërshtuar çdo lloj ndryshimi territorial pa pajtimin e shtetit në fjalë. Përderisa katër vendet e tjerat të BE-së që refuzojnë ta njohin Kosovën nuk japin



asnjë shenjë se mund ta bëjnë atë, çdo ndryshim politik nga ana e Rumanisë do të binte në sy. Kjo e bën çdo lloj ndryshimi edhe më pak të mundur.

Përderisa katër vendet e tjera anëtare të BE-së vazhdojnë të mos e njohin pavarësinë e Kosovës për arsye të njejtë - dhe, përkundrazi, në rastin e Spanjës këto arsye vetëm sa janë bërë më akute - është e vështirë të presim ndonjë lëvizje të koordinuar drejt njohjes së Kosovës, apo ndonjë ndryshim të njëanshëm nga ana e Bukuresht-

tit. Bukureshti do të ndryshonte qëndrim vetëm në rast se klima ndërkombëtare bëhet më favorshme dhe Rumania do të jetë e gatshme të përballoj pasojat që për momentin Bukureshti nuk është në gjendje ta bëj. Rumania nuk do që të krijoj bindjen se parimi i integritetit territorial të vendeve është dobësuar, ose të arsyetoj ndryshimin e qëndrimit brenda Rumanisë. Për momentin, Rumania është e prirur të vazhdoj ta ndjek zhvillimin e marrëdhënies mes Beogradit dhe Prishtinës dhe ta artikuloj pozitën e vet në bazë të kësaj.

08 QIPROJA

ISABELLE IOANNIDES

Si pasojë e invazionit dhe okupimit turk të një të tretës së ishullit në veri, si dhe problemi i pazgjidhshëm i Qipros (apo “çështja kombëtare” siç e quajnë në greqisht), qeveria e Qipros është pozicionuar gjithmonë kundër njohjes së shtetësisë së Kosovës. Ky ngërç i vazhdueshëm ndodh për shkak se politika e jashtme e Qipros përmban një komponentë të fortë ‘vlerash’ që bazohet në të ashtuquajturat ‘qëndrime parimore’, që janë kryesisht ligji ndërkombëtar dhe respektimi e të drejtave të njeriut. Në këtë kontekst, Nikozia ka insistuar vazhdimisht që statusi final i Kosovës të përcaktohet brenda kornizës së dialogut dhe

negociatave mes Prishtinës dhe Beogradit, dhe të aprovohet nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së. Për këtë arsye, Nikozia e ka mbështetur vendosjen e misionit të OKB-së dhe organizatave të tjera në Kosovë, si dhe kanalizimin e ndihmave humanitare të BE-së.

Në vitin 2009, qeveria e Qipros dërgoi edhe një deklaratë me shkrim tek Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND), ku shprehte mendimin e vet mbi situatën e Kosovës. Aty thuhej se institucionet e Kosovës nuk e kanë kompetencën ligjore për ta shpallur pavarësinë dhe, rrjedhimisht, shpallja nuk është në përputh-



je me ligjin ndërkombëtar; si dhe, të drejtat e Kosovës mbesin ato që janë përcaktuar nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së (1999) dhe proceset që kjo rezolutë parasheh (paragrafi 192 dhe 193). Nikozia gjithashtu ka mbajtur qëndrim të ashpër kundër liberalizimit të vizave për Kosovën nga BE-ja, duke kundërshtuar fuqishëm edhe njohjen e dokumenteve të udhëtimit të Kosovës, ashtu siç i kundërshton edhe pasaportat e ‘Republikës Turke të Qipros Veriore’ (RTQV). Megjithatë, kosovarët mund të hyjnë në Republikën e Qipros nëse kanë vizë shumë-hyrëse Shengen. Gjithashtu, duke u bazuar në të njëjtat premisa, në vitin 2015, Nikozia votoi kundër kërkesës së Prishtinës për anëtarësim në UNESCO.

Një faktor tjetër që e ka shënjuar qëndrimin e Qipros, është edhe natyra e lidhjeve bilaterale që ajo ka me vendet e Ballkanit Perëndimor. Qysh në fillimet e konfliktit në Jugosllavi, në vitin 1991, e deri në shpërbërjen e plotë të Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) në vitin 2006, Nikozia ka shprehur përkrahje të plotë ndaj çështjes serbe, edhe pse zyrtarisht i respektonte sanksionet e ushtruara nga OKB-ja. Në nivel popullor, shumica e grekëve qipriotë solidarizohen me serbët. Ata janë, sipas tyre, viktimë e seperatizmit, dhe e krahasojnë shpalljen unilaterale të pavarësisë së Kosovës me atë të ‘RTQV’-së. Ata identifikohen me Serbinë edhe nëpërmjet prizmes kulturore dhe fetare të Krishterimit Ortodoks. Gjithashtu, Serbia është i vetmi vend në Ballkanin Perëndimor që ka marrëdhënie të rëndësishme tregtie dhe turizmi me Qipron. Në nivel politik, Beogradi është i vetmi kryeqytet në rajon ku Qi-

pro ka hapur Ambasadë, dhe këto dy vende mirëmbajnë raporte të rregullta. Mirëpo, duhet theksuar edhe se, përderisa qëndrimet e BE-së nuk e rrezikojnë ‘çështjen kombëtare’, Nikozia gjithashtu ka treguar se ndonjëherë mund të marrë qëndrime të papritura politike. Për shembull, në vitet 1998 dhe 2000, Qipro ushtroi ndaj RFJ-së embargo naftë dhe armësh, ndalim fluturimesh dhe zyrtarësh, si dhe sanksione financiare.

Pavarësisht kundërshtimit të shpalljes unilaterale të pavarësisë së Kosovës, dhe lidhjeve të forta me Serbinë, diskursi i Nikozisë për mosnjohjen ka ndryshuar këto dhjetë vitet e fundit. Në vitin 2008, Ministri i Jashtëm i asaj kohe, Markos Kyprianou e vuri theksin te ‘qëndrimi parimor’ i Qipros. Nikozia shkoi aq larg sa deklaroi se nuk do ta njoh Kosovën, edhe në rast se Serbia e njeh. Sot Nikozia e ka kuptuar se Qipro nuk mund të jetë më serbe se vet Serbia, dhe e pranon se nëse Serbia e njeh Kosovën, edhe Qipro do të veproj njëjloj.

Një tjetër faktor që ka ndikuar në mundësitë, ose vullnetin e Nikozisë për t’u angazhuar me Kosovën, ka qenë edhe politika e ‘konsensusit evropian’. Edhe pse Qipro vazhdon ta kundërshtoj me këmbëngulje shtetësinë e Kosovës, qeveria e Qipros është e vendosur të veproj si anëtare konstruktive e BE-së, dhe punon drejt arritjes së konsensusit sa i përket politikave të BE-së. Ajo nuk dëshiron të duket si i vetmi vend që e kundërshton një vendim të caktuar të BE-së. Këtë e dëshmon edhe mënyra se si Qipro u soll gjatë vendosjes së misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX).



Edhe pse fillimisht qeveria e Qipros e kundërshtoi vendosjen e këtij misioni CSDP (Siguria e Përbashkët dhe Politika e Mbrojtjes), në momentin që u gjend e vetme përballë vendeve tjera anëtare - përfshirë ato që janë kundër pavarësisë - ajo e pranoi këtë vendim (por me abstënim vote). Qipro është vendi i vetëm mos-njohës që nuk kontribuon në këtë mision, edhe pse merr pjesë në takimet dhe vendimet që kanë të bëjnë me misionin dhe aprovimin e buxhetit. (Qipro ka kontribuar edhe në misionet politike të BE-së në Bosnje dhe Hercegovinë, dhe në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë - FYROM). Gjithashtu, Qipro është pozicionuar haptas për një të ardhme evropiane për rajonin. Presidenca gjashtë mujore e Qipros në BE, në vitin 2012 ka qenë moment vendimtar për ta shprehur këtë dedikim dhe për të sfiduar bindjen se politika e jashtme e Qipros është 'e njëanshme', dhe definohet vetëm në terma të 'çështjes kombëtare'. Mirëpo, ajo çfarë ra në sy ishte se, Ministri i Jashtëm Erato Kozakou Markoulli, zhvilloi vizita në Serbi, Mal të Zi, Bosnje dhe Hercegovinë, FYROM dhe më pas priti në Nikozi delegacione shqiptare dhe serbe, dhe vetëm Kosova nuk ishte pjesë e këtij shkëmbimi vizitash.

Pas zgjedhjeve të shkurtit 2013, presidenti i ri i qendrës së djathtë dhe pro-perëndimore, Nicos Anastasiades, e kishte si synim hyrjen në programin e Partneritetit për Paqe të NATO-s dhe forcimin e marrëdhënjëve me Shtetet e Bashkuara. Kjo, bashkë me marrëveshjen e arritur në Bruksel mes Prishtinës dhe Beogradit në prill 2013, e cila krijoi një kontekst të ri të 'normalizimit' të raportit mes Kosovës dhe Serbisë,

i dha Nikozisë arsyen për ta zbutur qëndrimin ndaj normalizimit të marrëdhënjëve me Prishtinën. Kjo është arsyeja se pse, në shtator 2013, Ministri i Jashtëm i Qipros, Ioannis Kasoulides u takua me Kryeministrin e Kosovës, Hashim Thaçin, në margjinat e Këshillit të Përgjithshëm të OKB-së në Nju Jork.

Mund të thuhet se, mendimi këshillimor i GJND-së mbi ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2010, i cili definoi qartë dallimet mes rastit të Qipros dhe Kosovës, ka shërbyer edhe si mekanizëm për ta zhbllokuar angazhimin potencial mes Nikozisë dhe Prishtinës. Megjithatë, vendimi i GJND-së nuk u instrumentalizua në asnjë formë, për shkak të bindjes së përgjithshme se njohja e Kosovës mund të krijoj një lloj precedenti, që do të shfrytëzohet nga autoritetet turko-qipriote. Është e rëndësishme të përmendet edhe se klima pozitive mes Nikozisë dhe Prishtinës në vitin 2013, krijoi edhe një bazë për njohje potenciale të Kosovës nga Athina. Mirëpo, në përgjithësi, ekziston bindja se, pavarësisht zbutjes së qëndrimit nga ana e Greqisë, Qiproja do të vazhdojë të ruajë 'qëndrimet parimore' të saj.

Kohëve të fundit ka pasur një përmbysje të trendeve pro-evropiane. Pas fillimit të tensioneve mes Rusisë dhe Perëndimit, partitë e vogla politike në vend që kishin qenë më të hapura ndaj përmirësimit të raporteve me NATO-n, tani i janë kthyer qëndrimeve më proruse. Përveç kësaj, edhe partia e majtë AKEL (Partia Progresive e Punës e Qipros), që është partia e dytë më e madhe në parlamentin qi-



priot, ka raporte të afërta me Rusinë. Kjo lëvizje është ndikuar edhe nga përshtypja se Rusia do ta mbrojë Qipron në rast të ndonjë presioni ndërkombëtar mbi ‘çështjen kombëtare’. Kjo mbështetje nga Moska mund të spjegoj edhe arsyet e distancimit të Qipros nga BE-ja sa i përket çështjeve specifike, siç është Kosova. Për më tepër, mungesa e progresit të mirëfillt të bisedimeve Beograd-Prishtinë, kanë krijuar bindjen se nuk ka vullnet të vërtetë politik për të gjetur një zgjidhje të ‘çështjes së statusit’ të Kosovës.

Bashkëpunimi mes shoqërisë civile në Kosovë dhe Qipro është i kufizuar. Në Nikozi janë zhvilluar seminare dhe shkëmbime mësimesh dhe përvojash mes OJQ-ve nga Ballkani Perëndimor, përfshirë edhe Kosovën, mbi sfidat me të cilat ballafaqohen shoqëritë e ndara. Është krijuar një rrjet i shoqërive civile dhe është në proces një program për zhvillimin e narrativave alternative historike të Ballkanit Perëndimor. Për më tepër, gazetarët qipriotë e kanë vizituar Kosovën dhe kanë raportuar përvojat e tyre në media. Gjithashtu, pas pranimit të Kosovës në FIFA në maj 2016, është zhvilluar edhe një ndeshje mes ekipeve të Qipros dhe Kosovës në Nikozia, në janar 2017.

Në muajt e fundit, BE-ja po fokusohet gjithnjë e më shumë në procesin e zgjerimit në Ballkanin Perëndimor. Deklaratat e fundit të Komisionerit Evropian Hahn për zgjerimin në rajon, kanë dhënë shenja për hapje në të ardhmen. Ai deklaroi se shanset e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën, janë më të mira sot sesa para një viti e gjysmë, por edhe duke potencuar se procesi drejt afrimit me BE-në do të thotë

zbatim reformash. Kjo vëmendje e ripërtërirë për pranim në BE, bashkë me qasjen e Qipros për ‘konsensus evropian’, mund t’i jap Nikozisë incentivën e duhur për t’u riangazhuar de facto me Prishtinën. Një mënyrë për ta kapur mundësinë për angazhim të Nikozisë në Kosovë, është angazhimi i qartë dhe konkret për zbatimin e marrëveshjeve tashmë të arritura mes Beogradit dhe Prishtinës. Megjithatë, dështimi i vazhdueshëm për gjetjen e një zgjidhje dhe mosndryshimi i qëndrimit nga ana e vendeve anëtare të BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën (sidomos Spanja), kriza e sotme katalane, si dhe dështimi i negociatave të fundit bikomunitare mbi problemin e Qipros, vetëm sa i kanë dhënë më shumë arsye Qipros për mosangazhim me Prishtinën.

Në përgjithësi, kur flitet për qëndrimin e qeverisë së Qipros ndaj Kosovës, nocioni i njohjes dhe angazhimit duhet të ndahen nga njëri-tjetri. Njohja e Kosovës nga Qiproja do të mbetet çështje e negociative mes Prishtinës dhe Beogradit, dhe aprovimit të zgjidhjes nga ana Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Mirëpo, angazhimi i raporteve de facto mes Nikozisë dhe Prishtinës, do të varet nga identifikimi i një momenti të duhur dhe shfrytëzimit sa më të mirë të mundësisë së dhënë. Kjo do të thotë se duhet ruhet një balancë e hollë mes dëshirës së Nikozisë për të mbajtur ‘qëndrim parimor’, qëndrimeve të vendeve mos-njohëse, përpjekjes së Nikozisë për ta shmangur izolimin brenda BE-së, progresit të bisedimeve Prishtinë-Beograd, dhe ndryshimeve të diskursit dhe veprimeve të BE-së në Ballkanin Perëndimor.

09 SPANJA

RUTH FERRERO-TURRIÓN

Tradicionalisht, Spanja nuk ka pasur raporte shumë të afërta me Ballkanin Perëndimor. Gjatë shekullit njëzet, lidhja e vetme mes tyre ishte prania e Brigadierëve Internacional Jugosllavë në Luftën Civile në Spanjë, por edhe qasja e ndrojtur e disa politikanëve spanjollë për ta ndjekur modelin jugosllav të mos-angazhimit. Por, që nga fillimi i viteve 1990-të dhe pas shpërbërjes së Jugosllavisë, Spanja ka interesim më të madh politik për rajonin, edhe pse marrëdhëniet tregtare por edhe ekonomike mes Spanjës dhe Ballkanit Perëndimor janë minimale.

Si një shtet shumëkombësh dhe me diversitet, Spanja gjithmonë e ka mbrojtur ekzistencën e vendeve me tipare të ngjashme. Kjo gjë vlente edhe për Jugosllavinë. Në vitin 1991, Francisco Fernández-Ordoñez, Ministri i atëhershëm i Spanjës për Punë të Jashtme, i propozoi Këshillit për Marrëdhënie me Jashtë nisjen e një procedure të përsheptuar të njohjes dhe zgjerimit për Jugosllavinë, si një mënyrë e vetme për të parandaluar shpërbërjen e vendit. Pavarësisht kësaj qasje parandaluese në fillimet e copëzimit të Jugosllavisë, Spanja më vonë i ndaloi qëndrimet reaguese sa i përket



zhvillimeve në Ballkan. Këtu bënte pjesë edhe kundërshtimi i lëvizjeve separatiste në rajon. Përgjithësisht, Spanja ka pasur prirjen që të ndjek rrugën e shënjuar nga Bashkimi Evropian dhe partnerët në NATO. Gjatë luftës në Bosnje, Spanja mori pjesë aktivisht në operacionet paqeruajtëse, veçanërisht në rajonin e Mostarit dhe në vitin 1999, qeveritë e Aznarit iu bashkangjiten alencës ndërkombëtare gjatë bombardimit të Serbisë nën ombrellën e NATO-s, që u bë në kohën kur Javier Solana ishte Sekretar i Përgjithshëm. Kjo prani e rëndësishme në terren, bashkë me simpatinë e kahmotshme që shumë njerëz në Ballkan e kanë për Spanjën për shkak të luftës civile, dhe përshtypjes se Spanja është vend neutral, do thotë se Spanja shihej pozitivisht. Kjo e spjegon pjesërisht edhe emërimin e disa spanjollëve në pozita të larta ndërkombëtare në Ballkanin Perëndimor, siç është rasti i emërimit të Carlos Westendorp si Përfaqësues i Lartë i Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Felipe González si Përfaqësues Personal i Kryesuesit të Zyrës për RFJ.

Në fakt, pavarësisht se Spanja perceptohet nga rajoni si vend neutral, politika e jashtme e Spanjës ndaj Ballkanit ka qenë përgjithësisht më sensitive ndaj Serbisë. Kjo kryesisht për shkak se Serbia perceptohet si thelbi i Jugosllavisë. Këtë e kanë dëshmuar ministrat e njëpasnjëshëm spanjollë të punëve të jashtme, pavarë-

sisht orientimit të tyre politik. Ndoshta ministrat më aktivë kanë qenë Josep Pique (2000-2002) and Migel Angel Moratinos (2004-2010). I pari provoi të nxis lidhje tregtare dhe investime mes Spanjës dhe Republikës Federale të Jugosllavisë (në atë kohë Serbisë dhe Malit të Zi). I dyti provoi të nxiste dialogun rajonal dhe bashkëpunimin mes Serbisë dhe Kosovës. Mbështetja e parzervuar ndaj Serbisë është vënë re edhe në politikën e Spanjës në raport me Kosovën, dhe aq më shumë me vendimin e menjëhershëm të Spanjës për mos ta njohur Kosovën pas shpalljes së së pavarësisë në shkurt 2008.

Megjithatë, ekzistojnë edhe dy faktorë tjerë se pse Spanja e kundërshton shtetësinë e Kosovës. E para, pas luftës së Irakut në vitin 2003, e cila u mbështet nga Madridi, qeveria socialiste e Spanjës (2004-2011) filloi ta mbronte fuqishëm ligjin ndërkombëtar. Në këtë kontekst, Spanja dha kontribut me deklarata të shkruara dhe verbale gjatë mendimit këshillues mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. E dyta, dhe më e rëndësishmja, shqetësimet e Spanjës mbi çështjen e Katalonisë kanë pasur ndikim të thellë në qëndrimin e saj. Në vitin 2009, ish Ministri i Punëve të Jashtme, José García Margallo, në një koment për një gazetë kosovare (Kosovo Times), deklaroi se Spanja nuk e njeh Kosovën për shkak të “parimeve që kanë të bëjnë me komu-



nitetet autonome baske dhe katalonase të Spanjës, edhe pse situata nuk është e krahasueshme”. Megjithatë, ai shtoi se edhe në rast se nuk e njeh Kosovën, Spanja do ta mbështes zhvillimin e saj.

Kur Partia Popullore e krahut të djathtë e mori pushtetin në vitin 2011, mundësitë për njohje u zvogëluan edhe më shumë. Në vitin 2008, kjo parti u prononcua e para kundër shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Ky qëndrim u mbështetet jo vetëm nga elitat partiake, por edhe nga simpatizantët e partisë të cilët e kundërshtojnë çdo lloj procesi pavarësie. Ky qëndrim mbështetet edhe nga gazetatat e djathta dhe të qendrës së djathtë në vend, siç janë La Razón, ABC dhe El Mundo. Me 14 mars 2012, Kryeministri i Spanjës, Mariano Rajoy, u tha deputetëve nacionalistë katalanas, se qëndrimi i Spanjës ndaj Kosovës nuk do të ndryshoj. Duke e thënë këtë, ai tërthorazi përmendi ‘faktorët e brendshëm’ për ta arsyetuar këtë qëndrim, duke argumentuar se ky vendim është “qëndrimi më i përshtatshëm për shumë njerëz në Spanjë”. Shqetësimet e brendshme mbi lëvizjet seperatiste, veçanërisht në Kataloni, e kanë forcuar pozitën e qeverisë këtyre viteve të fundit. Me rritjen e tensioneve në Spanjë për shkak të Katalonisë, edhe pozicioni i Spanjës ndaj Kosovës është ashpërsuar. Ashtu çfarë është gjendja sot, nuk do të ketë njohje të asnjë shteti që e ka shpallur pavarësinë në mënyrë unilaterale.

Një pikë tjetër e rëndësishme për t’u theksuar është edhe kjo: problemi kryesor që Spanja ka me Kosovën ka të bëjë me ‘procesin’ se si u bë shpallja e pavarësisë. Spanja nuk i kundërshton krijimet e shteteve të reja. (Ajo e ka njohur Malin e Zi në vitin 2006, dhe Sudanin e Jugut në vitin 2011). Por Spanja është kundër akteve unilaterale të ndarjes. Ky mendim vetëm sa është forcuar pas shpalljes unilaterale të pavarësisë nga ana e separatistëve katalanas në tetor, 2017. Edhe nëse vendet e tjera të BE-së e quajnë rast sui generis, autoritetet spanjolle kanë frikë se Kosova është një precedent që mund të përdoret edhe në vendet e tjera të Evropës. Spanja ishte plotësisht kundër referendumit për pavarësinë e Krimesë, dhe shprehu edhe rezerva për referendumin e mbajtur në Skotlandë. Edhe pse këto janë raste krejt të ndryshme, Madridi përdor argumentin e njejtë se “Spanja nuk është Krime, as Kosovë, e as Skotlandë.” Vetëm pak njerëz e kuptojnë dallimin mes këtyre rasteve.

Megjithatë, Spanja e mbështet anagazhimin mes Beogradit dhe Prishtinës. Marrëveshja mes Serbisë dhe Kosovës është parë pozitivisht. Nëpërmjet punës diplomatike në Beograd, Madridi edhe ka ndihmuar që këto marrëveshje të ndodhin. Kështu, Spanja e ka përdorur edhe raportin e privilegjuar që e ka me Serbinë, e cila e konsideron si një vend mik, për ta shtyrë përpara dialogun në të dyja anët. Duhet



theksuar gjithashtu se deri në vitin 2009, Spanja ka qenë donatori i gjashtë më i madh i UNMIK-ut dhe KFOR-it. Mirëpo, Spanja nuk ka pranuar që të merrte pjesë në misionet e udhëhequra nga NATO dhe EULEX-i për arsyen se këto jepnin kontribut për të ndërtuar një shtet të ri. Në vitin 2009, Madridi deklaroi se gradualisht do t'i tërhiqte të gjithë ushtarët e saj që ndodheshin në Kosovë.

Përveç kësaj, iniciativa private diplomatike kanë ndodhur edhe me Serbinë edhe me Kosovën. Sa i përket Kosovës, kjo lidhje është bërë nëpërmjet organizatave think tank siç është Real Instituto Elcano, Fundación CIDOB apo Këshilli Evropian për Marrëdhënie me Jashtë. Këto kanë ftuar akademikë dhe aktivistë për të marrë pjesë në seminare që kishin në fokus situatën në Kosovë. Këto takime, megjithatë, nuk janë bërë publike. Pjesëmarrja ka qenë vetëm me ftesa. Duhet thënë se në të tilla raste, pjesëmarrësit nga Kosova e kanë pasur të vështirë të udhëtojnë sepse Spanja nuk i njeh pasaportat kosovare. E vetmja mënyrë për të hyrë në Spanjë është me dokumentet e udhëtimit të lëshuara nga Misioni i Përkohshëm Administrativ i Kombeve të Bashkuara në Kosovë për qytetarët banorë të Kosovës. (Edhe pasaportat e qytetarëve të Republikës së Kosovës, që banojnë në një vend të zonës Shengen që e ka njohur Republikën e Kosovës, nuk njihen në Spanjë).

Njohja e Kosovës nga Spanja nuk ka gjasë të ndodhë as në të ardhmen. Në mars 2017, partia politike separatiste katalane tentoi ta propozonte njohjen, por u refuzua në Senat nga partitë kryesore politike. Edhe pse mund të ndërmerren hapa për ta nxitur Madridin të anagazhohet me Prishtinën, për shembull në sferën e institucionalizimit dhe forcimit të sundimit të ligjit, e vërteta është se për sa kohë nuk ndalojnë tensionet territoriale brenda Spanjës, apo nuk ka ndonjë ndryshim rrënjësor të qeverisë, shanset për angazhim më të madh, e aq më pak për njohje, janë minimale.

10 DIPLOMACIA KOSOVARE PAS PAVARËSISË

AGON DEMJAHA

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, qeveria e Kosovës mori përsipër detyrën e vështirë për të marrë sa më shumë njohje ndërkombëtare dhe për të ndërtuar institucionet e vendit. Procesi i njohjes ndërkombëtare të shtetit të Kosovës është parë nga autoritetet e Kosovës si një hap i domosdoshëm dhe i qenësishëm që do ta forcoj edhe më tej pozitën e Republikës së Kosovës ndërkombëtarisht. Sot, pothuajse

10 vite pas shpalljes së pavarësisë, numri i njohjeve ka arritur në 114 ¹, ndërkohë që pesë vende anëtare të Bashkimit Evropian dhe dy anëtareve të përhershme të Këshillit të Sigurimit në OKB vazhdojnë të refuzojnë ta njohin Kosovën. Deklarata zyrtare e Ministrisë së Punëve të Jashtme e Kosovës (MPJ) sa i përket njohjeve ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës është se me arritjen e 114 njohjeve, MPJ e ka arritur qëllimin fillestar të arritjes së më shumë se 100

1 Problemi i numrit të saktë të njohjeve është mjaft i paqartë, për shkak të shifrave të ndryshme nga burime të ndryshme. Përderisa NFA përdor numrin 114, është e paqartë nëse Uganda dhe Nigeria e kanë njohur Kosovën. Gjithashtu, kohëve të fundit është raportuar nga disa media se Surinami e ka tërhequr njohjen.



njohjeve. Sipas MPJ-së, meritat për arritjet deri sot i takojnë “diplomacisë proaktive dhe dinamike të Kosovës, si dhe të partnerëve ndërkombëtarë që kanë lobuar për njohjen e Kosovës”. Mirëpo, është akoma e paqartë se cili ka qenë afati kohor për arritjen e 100 njohjeve të para dhe nëse përpjekja e përgjithshme e diplomacisë kosovare gjatë lobimit për njohje të pavarësisë së Kosovës mund të konsiderohet e suksesshme. Edhe më e rëndësishme është pyetja se cilat janë mësimet kryesore nga politikat e (mos)njohjeve në kontekstin aktual kur pranimi i njohjeve të reja është bërë tejet i vështirë, ndërkohë që pesë vendet anëtare mos-njohëse të BE-së vazhdojnë të refuzojnë ta njohin Kosovën?

Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, objektivat kryesore të strategjisë së politikës së jashtme të Kosovës ishin “avancimi i vazhdueshëm i pozitës ndërkombëtare të Kosovës dhe forcimi i përkrahjes ndërkombëtare për sovranitetin e Kosovës”. Në këtë linjë, “sigurimi i njohjes së shtetit të Kosovës” shihej si një “parakusht për konsolidimin e brendshëm të shtetit të Kosovës”. Rrjedhimisht, menjëherë pas deklaratës së pavarësisë, Kosova filloi krijimin e insitucioneve për politikë të jashtme dhe shërbimeve diplomatike të cilat do të angazhoheshin plotësisht në lobimin për njohje të pavarësisë së vendit. Si rezultat, në prill 2008, Qeveria e Kosovës themeloi MPJ-në, ndërsa nga tetori 2008,

Kosova vendosi dhjetë charge d'affaires të parë të cilët filluan punë si ambasadorë të Prishtinës në disa nga vendet më të mëdha që e njohën Kosovën. Fillimisht, lobimi intensiv për njohje u mbështet fuqishëm nga disa partnerë ndërkombëtarë perëndimor, sidomos nga SHBA-të dhe Britania. Kështu, deri në fund të vitit 2008, Kosova përfitoi 53 njohje, përfshirë 22 nga vende anëtare të BE-së, dhe një numër i madh i shteteve të rëndësishme si SHBA-të, Kanadaja, Norvegjia, Zvicra, Australia dhe Turqia. Mirëpo, gjatë vitit 2009, numri i njohjeve ra në vetëm 11, në mesin e të cilave vlen të përmenden njohjet e rëndësishme nga vendet fqinje si Maqedonia dhe Mali i Zi. Në vitin 2010 numri i njohjeve ra edhe më shumë, në vetëm 8, edhe pse vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) në lidhje me shpalljen unilaterale të pavarësisë së Kosovës u pa si një gjë pozitive nga të gjitha elitat politike kosovare.

Kur vendimi i GJND-së nuk dha rezultatet e shumëpritura dhe numri i njohjeve të reja ra dukshëm, në vitin 2011 MPJ hartoi “Strategjinë për Arritjen e Njohjes së Plotë Ndërkombëtare të Republikës së Kosovës”. Kjo strategji duhej të shërbente si kornizë për arritjen e qëllimit strategjik të Kosovës për njohje ndërkombëtare duke përdorur mjete të ndryshme, tërësore dhe gjithëpërfshirëse. Implementimi praktik i Strategjisë duhej koordinuar me partnerët strategjik të Kosovës dhe në partneritet me vende të



tjera specifike botërore. Edhe pse ky dokument u klasifikua si konfidencial, intervistat tregojnë se kjo Strategji përmbante mjete të ndryshme dhe plotësuese veprimi për njohje të reja. Sipas të intervistuarve, strategjia ofronte një platformë të qartë dhe profesionale orientimi, që përfshinte informata të dorës së parë si dhe analiza të sakta dhe të realizueshme për vende dhe rajone të ndryshme. Megjithatë, të intervistuarit besojnë se dështimi për ta zbatuar strategjinë ishte pasojë e mungesës së koordinimit ndërinstitutional që ishte parashikuar si pjesë e strategjisë. Gjithashtu, ata thonë se një pengesë e madhe për një diplomaci efektive ka qenë edhe tendenca e lobimit kryesisht në nivele politike dhe mungesa e koordinimit të duhur me rrjetin diplomatik. Në vend të koordinimit dhe krijimit të një kulture shteti, përpjekjet për njohje shpesh janë personalizuar dhe përdorur nga aktorë të ndryshëm për promovim politik personal, duke e dobësuar kështu seriozisht zbatimin e strategjisë.

Përveç strategjisë për njohje të drejt-përdrejtë, në vitin 2011 MPJ e Kosovës filloi gjithashtu një fushatë të gjërë dhe shumëdimensionale informimi që për herë të parë përdorte mjete të diplomacisë publike në mënyrë që të rritej ndërveprimi i përgjithshëm mes Kosovës dhe vendeve mos-njohëse dhe publikut të tyre, veçanërisht në pesë vendet e BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën. Ky qëllim duhej të

arrihej nëpërmjet krijimit të kanaleve të ndryshme të komunikimit mes shoqërisë civile, bizneseve, akademise dhe mediave në Kosovë dhe kolegëve të tyre në vendet e synuara. Aktivitetet e para diplomatike ishin pjesë e nje projekti të përbashkët mes MPJ-së së Kosovës dhe zyrës së Qeverisë Britanike, e themeluar nga zyra e Këshillit Britanik në Kosovë dhe që kishte për synim promovimin e diplomacisë publike si një instrument për forcimin e marrëdhënjeve mes shtetit të Kosovës dhe vendeve që nuk e kishin njohur ende Kosovën. Ky projekt përfshinte edhe aktivitete të avokimit dhe informimit, në mënyrë që të krijoheshin kanale të qëndrueshme komunikimi me vendet e synuara duke përfshirë edhe personalitete të njohura publike, shoqërinë civile, mediat dhe intelektualë të mirënjohur. Në kuadër të aktiviteteve diplomatike, u organizuan edhe disa vizita nga parlamentar, përfaqësues biznesesh, shoqëri civile dhe media nga Kosova drejt vendeve anëtare të BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën. Me qëllimin e prezantimit dhe promovimit të interesave kombëtare të Kosovës dhe rritjen e numrit të njohjeve, Kosovën e vizituan edhe disa grupe me aktorë të ndryshëm dhe gjithëpërfshirës që vinin nga vendet anëtare të BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën.

Ndërkohë, Ministria e Punëve të Jashtme e ka prioritetizuar Diplomacinë Digjitale si një nga shtyllat kryesore të angazhimit dhe




si një nga mjetet vitale për të mbështetur njohjen e Kosovës duke ofruar informata të vërteta dhe pozitive prej dhe për Kosovën. Për këtë arsye, u hartua edhe Strategjia e Diplomacisë Digjitale, dhe u ndërmorrën një grumbull aktivitetesh, që fokusoheshin kryesisht në lobimin e vazhdueshëm për njohje të Kosovës nga infrastruktura globale e internetit, duke ndryshuar përmbajtjen e burimeve më të mëdha të informacionit në internet, duke e forcuar narrativën për Kosovën dhe duke shtyrë një përmbajtje me cilësi të lartë për audiencat e synuara. E gjithë fushata kishte një qasje mjaft profesionale dhe inovative të diplomacisë digjitale, përderisa vet strategjia u vlerësua nga revista turke Yeni Diplomasi si e një nga katër më të mirat, pas Mbretërisë së Bashkuar, Shteteve të Bashkuara dhe Izraelit. Gjithashtu, DigitalKosovo.org u shpall si një nga portalet më të mira të angazhimit digjital, bashkë me faqen e diplomacisë digjitale të Departamentit të Shtetit të SHBA-ve, ndërsa faqja e Facebook-ut e Ministrisë së Jashtme të Kosovës u listua si faqja më e suksesshme angazhuese e publikut në internet.

Megjithatë, pavarësisht këtyre aktiviteteve, numri i njohjeve ngeli relativisht i ulët, me 13 njohje gjatë vitit 2011 dhe 2012 respektivisht, 7 njohje në vitin 2014 dhe vetëm një njohje gjatë vitit 2015. Në vitin 2016, Kosova arriti të merrte dy njohje, ndërsa deri sot, gjatë vitit 2017 ka ndodhur vetëm një njohje. Sipas zyrtarëve të lartë të Këshillit Britanik, aktivitetet e kryera të diplomacisë digjitale kanë arritur të plotësojnë një boshllëk të njohurive bazë që vendet që nuk e kanë njohur Kosovën e kanë pasur në përgjithësi për Kosovën bashkëkohore, dhe ndërkohë, ka krijuar urat e para lidhëse mes Kosovës dhe pesë vendeve mos-njohëse anëtare të BE-së. Mirëpo, në momentin kur këto aktivitete përfunduan, nuk pati asnjë plan të qartë se si do të vazhdohej me rrugëtimin apo veprimet, dhe nuk pati asnjë aktivitet pasues. Në situatën e tanishme, kur pranimi i njohjeve është bërë tejet e vështirë, Kosova ka nevojë për një plan veprimi të menduar mirë dhe të koordinuar nga gjithë aktorët e politikave të jashtme në Kosovë. Ngjashëm, sipas një ish-diplomati të Kosovës, ministri e mëparshëm të politikës së jashtme i kanë politizuar shërbimet diplomatike duke emëruar militant partiak, dhe duke injoruar meritokracinë brenda shërbimit, edhe në rastet e emërimeve dhe promovimeve.



Pas disa muajsh krize institucionale, më 9 shtator Kosova arriti të formoj një koalicion qeverisës. Përveç dy partive të reja, qeveria aktuale ka edhe një Kryeministër të ri dhe një Ministër të ri të Punëve të Jashtme. Menjëherë pas inagurimit, aktivitetet e qeverisë së re u penguan dukshëm nga zgjedhjet lokale që u zhvilluan në tetor. Rrjedhimisht, që nga marrja e pushtetit, qeveria e re pothuajse nuk i ka zënë me gojë njohjet e reja, dhe as nuk ka iniciuar përgatitjet për një strategji lobimi për njohje të reja, edhe pse ka vite që partnerët ndërkombëtarë i kanë shtyrë qeveritë e Kosovës të prodhojnë strategji të plota dhe të realizueshme për të siguruar njohje të reja. Sa i përket njohjeve të reja të pavarësisë së Kosovës, situata për momentin është mjaft kritike. Koha e njohjeve të lehta, të arritura kryesisht me ndihmën e lobimit të

vendeve të mëdha përendimore, ka marrë fund. Situata e brendshme është përfshirë nga korrupsioni, krimi i organizuar dhe nepotizmi, ndërkohë që emërimi i diplomatëve të Kosovës bëhet pa meritokraci, transparencë dhe profesionalizëm. Krizat e njëpasnjëshme, pas pothuajse çdo cikli parlamentar, e kanë dëmtuar seriozisht imazhin e Kosovës jashtë vendit. Vendi ka nevojë urgjente për një plan inovativ dhe gjithëpërfshirës për të marrë njohje të reja si dhe një trup ndërinstitucional që do të merret me zbatimin e plotë të këtij plani. Njëkohësisht, ky plan duhet shoqëruar me një qasje të re dhe kreative të diplomacisë publike që do ta rris komunikimin dhe do ta forcoj bashkëpunimin me institucionet qeveritare dhe publikun e gjërë të vendeve që nuk e kanë njohur Kosovën.





Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo